



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 26 (827881)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 korrik 2024

Të gjithë efektivet e Forcave të Armatosura dhe punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes do të përfitojnë rritje të pagave.


Kjo rritje përfshin nga Ushtari I deri te Gjenerali dhe është një hap i rëndësishëm dhe një politikë që njeh dhe vlerëson përkushtimin dhe sakrificat e burrave dhe grave që shërbejnë në Forcat e Armatosura. Shpërblim të drejtë për kontributin e tyre të çmuar në mbrojtjen e atdheut.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RRITJA E PAGAVE TË USHTARAKËVE

TETAR



Fjala përshëndetëse e SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji, në mbyllje të stërvitjes 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët-24”

Me rastin e mbylljes së stërvitjes 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët-24”, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji mbajti një fjalë përshëndetëse për realizimin me sukses të kësaj stërvitjeje nga Forcat e Armatosura. Mes të tjerash gjeneralmajor Kingji tha: “Përgëzoj të gjithë efektivin e Forcave të Armatosura, për mbylljen me sukses të stërvitjes 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët-24”, gjatë së cilës keni treguar profesionalizëm dhe përkushtim në planëzimin, koordinimin dhe zhvillimin e operacioneve komplekse ushtarake. Kjo stërvitje ka shërbyer për testimin e kapaciteteve të reja operacionale, doktrinae, procedurave dhe elementëve



të Planit Kombëtar të Mbrojtjes, në mbështetje të Planit Rajonal Juglindor të NATO-s. Ia kemi dalë të përmbushim me sukses qëllimin kryesor, që është ndërveprueshmëria dhe kompaktësimi i veprimeve në shtab nga niveli strategjik në atë taktik, eksperimentimi i strukturës së Forcës së Bashkuar të Organizuar për Detyrë, dhe testimin e mjeteve ajrore pa pilot në mbështetje të operacioneve. Kjo stërvitje do të kontribuojë në përmbushjen me sukses të aktiviteteve të rëndësishme stërvitore që na presin, si stërvitja “Defender Europe” në vitin 2025 dhe stërvitja certifikuese e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, në vitin 2026.

“Përpjekja e Përbashkët 2024”, ministri Peleshi: Një test real i planeve kombëtare në mbështetje të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, përshëndeti përfundimin me sukses të stërvitjes më të madhe kombëtare të Forcave të Armatosura “Përpjekja e Përbashkët 2024”.

Në prani të gjeneralëve, komandantëve, oficerëve, nënoficerëve e ushtarëve pjesëmarrës, ministri Peleshi deklaroi se kjo stërvitje ka rëndësi të madhe për vendin tonë, pasi shërben edhe si një test real i planeve kombëtare në mbështetje të planeve rajonale të NATO-s. “Kjo stërvitje vuri në provë kapacitetet tona reaguese në rast të aktivizimit të Artikullit 5 të NATO-s, atë të mbrojtjes kolektive, gatishmërinë e forcave, aftësitë dislokuese, komandim-kontrollin, sigurimin e pikave të debarkimit detar dhe ajror, sigurimin e infrastrukturës kritike, si dhe zhvillimin e operacioneve mbrojtëse dhe mësymëse të trupave të deklaruara për t’u dislokuar jashtë vendit”, - u shpreh ministri Peleshi. Referuar mjedisit të sotëm të sigurisë, ministri Peleshi vuri në dukje faktin se në përmbushje të angazhimeve kombëtare dhe atyre të deklaruara në NATO, vendi ynë ka ndërmarrë një sërë procesesh të rëndësishme për zhvillimin e Forcave të Armatosura, për të qenë sa më moderne, profesioniste dhe të afta për të përmbushur misionin kushtetues dhe tërësisht të ndërveprueshme me vendet e Aleancës. “Ne jemi të vendosur për të konsoliduar dimensionin operacional dhe taktik, duke vendosur theksin te transformimi i pandërprerë i forcave dhe kapaciteteve ushtarake. Modernizimi i FA-ve me pajisje moderne, sisteme të mbrojtjes kundërajrore dhe kundërtanke, të vëzhgimit dhe monitorimit të hapësirës ajrore dhe detare, krahas projekteve për përmirësimin e infrastrukturës ushtarake, e bëjnë vendin tonë një aset të rëndësishëm



të Aleancës, në mbështetjen e operacioneve në kuadër të shkurajimit dhe mbrojtjes kolektive”, - theksoi në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes. Ministri foli edhe për vendimin e fundit të qeverisë për rritjen e pagave për të gjithë efektivët e Forcave të Armatosura. “Përfitoj nga rasti për të rikonfirmuar mbështetjen e qeverisë në drejtim të Forcave të Armatosura, nëpërmjet pagave të reja të miratuara së fundmi. Kjo rritje filloi në vitin 2022 dhe aktualisht shkon në 40%! Është një premtim i mbajtur dhe angazhim i kryeministrit që pagat e Forcave të Armatosura të rriten çdo

vit deri sa të arrijmë nivelin mesatar të vendeve të Aleancës”, - theksoi ministri Peleshi. Stërvitja “Përpjekja e Përbashkët 2024”, që u zhvillua në Bizë, sinkronizoi aftësitë ndërvepruese të niveleve komanduese e drejtuese si dhe ekzekutimin e



veprimeve luftarake të trupave në terren. Në këtë stërvitje u angazhuan rreth 2000 trupa, qindra mjete tokësore, anije të Forcës Detare, helikopterë të Forcës Ajrore, si dhe për herë të parë dronët “Bayraktar TB2”.

Komanda Mbështetëse dhe strukturat e saj, në mbështetje të stërvitjes së SHP “Përpjekja e Përbashkët-24”

Në stërvitjen 3-shkallëshe të FA-së, “Përpjekja e Përbashkët-24”, Komanda Mbështetëse është angazhuar së bashku me strukturat vartëse për mbështetjen me kapacitete dhe shërbime logjistike, sipas klasave të furnizimit të FBOD dhe trupave pjesëmarrëse në stërvitje në zonën e operacionit Bizë dhe vend-dislokimin Rrapi i Treshit. Kjo stërvitje synon të testojë kapacitetet e mbështetjes logjistike me furnizim, kapacitetet EOD, kapacitetet xheniere, transport trupash, mjete, teknikë dhe ngritjen e setit fushor.

Pas përfundimit të fazës planëzuese ka filluar mbështetjen e operacionit “Stuhia 24”, duke vendosur në dispozicion të Forcës Tokësore personel, mjete dhe pajisje si dhe duke ngritur setet fushore në të dyja rajonet e stërvitjes.

Efektivët e grup-batalionit gjatë lëvizjes për në rajonin e zhvillimit të operacionit, u përballën me dy incidente, të cilat kërkuar ndërhyrjen e specializuar të efektivëve të togës EOD.

Duke përdorur me përpikëri teknikat dhe procedurat e parashikuara në manualin EOD ML 400-5-2, ekspertët EOD asgjësuan municionet e paplasura në rrugëkalimin e lëvizjes dhe kryen kontrollin e një automjeti për prezencë



mjeti shpërthyes, duke përdorur pajisjet dhe teknikat moderne EOD.

Komanda Mbështetëse vazhdon monitorimin dhe ndjekjen e aktivitetit operacional.

Forca Ajrore në DVD e stërvitjes “Përpjekja e Përbashkët - 24”

Në stërvitjen “Përpjekja e Përbashkët - 24”, Forca Ajrore (FAj) u angazhua në realizimin e transportit të personelit ushtarak VIP, të personelit të ROS.

Një tjetër detyrë e FAj-së në bashkëpunim me FT-në, ishte bashkëpunimi dhe koordinimi për realizimin e skenarit demonstrues të kapjes së shpejtë të kundërshtarit.

Për herë të parë në këtë stërvitje, krahas helikopterit “Cougar”, u kryen fluturime me helikopterin “Black Hawk” nga dy pilotët, nënkolonel Ervin Buzi dhe major Klajdi Tushe.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Rrisim ndjeshëm aftësitë tona të mbikëqyrjes dhe sigurisë



Nisin për herë të parë misionin e tyre dronët “Bayraktar”. Imazhet e para të tyre u përcollën nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili gjatë demonstrimit të dronëve u shpreh: “Krenarë të ndajmë sot imazhet e para nga dronët “Bayraktar”. Këta dronë, teknologjia më e lartë e fluturimeve për misione ushtarake, po rrisin ndjeshëm aftësitë tona të mbikëqyrjes dhe sigurisë. Një hap i madh përpara në mbrojtjen kombëtare”.

Prej disa muajsh Forcat e Armatosura shqiptare kanë në zotërim 3 dronë “Bayraktar”, të blerë në Turqi në bazë të një marrëveshjeje mes dy vendeve.

Këta dronë janë të njohur për efikasitetin dhe teknologjinë e tyre të avancuar. Ata do të shërbejnë edhe për monitorimin e territorit dhe imazhet e tyre do të jenë në shërbim të institucioneve të shtetit. Ky



është një tjetër hap i rëndësishëm në modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, në përmbushje të detyrimeve të aleancës së NATO-s.

Qeveria shqiptare realizoi dhe një tjetër premtim të dhënë, atë të rritjes së pagave, që ashtu si të gjitha ministrat dhe strukturat e varësisë së tyre dhe Ministrisë së Mbrojtjes iu dha një vëmendje e shtuar në rritjen e re të pagave për Forcat e Armatosura dhe personelin civil të administratës publike. Në deklaratën e bërë pas mbledhjes së qeverisë, ministri Peleshi tha se kjo është një rritje domethënëse që prek të gjitha nivelet, nga ushtari I e deri te gjeneralët, ndërsa theksoi se pagat e ushtarakëve do të rriten çdo vit, deri sa të arrijnë nivelin e pagave të vendeve të Aleancës.

“Kjo rritje filloi në vitin 2022, me rritjen më të madhe të historisë të pas viteve ’90 në Shqipëri, me 30%, dhe është një premtim dhe angazhim i kryeministrit që pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit deri sa ne të arrijmë nivelin mesatar të vendeve të Aleancës, ku bëjmë pjesë. Pagat e Forcave të Armatosura do të rriten çdo vit! Jemi shumë afër, duke kaluar vendet e rajonit, duke shkuar drejt vendeve dinjitoze”, - u shpreh Ministri i Mbrojtjes. Në deklaratën e tij, ai specifikoi edhe nivelin e rritjes që nis nga 1 korriku. “Për ushtarin IV, paga bazë do të shkojë në 71.000 lekë, sipas gradës dhe viteve të shërbimit, nga 42.000 lekë në vitin 2019, pra një rritje në këto vite prej 29.000 lekësh. Të gjitha pagat që do të lexoj, iu shtohet dhe trajtimi me ushqim që jepet në formën e kompensimit ushqimor prej 16.000 lekësh.

Pra një ushtar VI nuk do të marrë 71.000 lekë, por do të marrë 87.000 lekë. Këtë duhet të dëgjojnë të gjithë të rinjtë, pasi kushdo që do të bëhet pjesë e Forcave të Armatosura e nis me një pagesë 87.000 lekë. Politika e këtij viti, e këtij vendimi është nga 7 deri në 22%, ku në ndryshim nga dy vitet e fundit, këtë vit do t’i japim më shumë prioritet gradave më të ulëta.

Rreshteri në vitin 2019 e ka patur pagën 48.200 lekë, me rritjen prej 30% shkoi në 62.660 lekë dhe me rritjen e sotme shkon në 80.000 lekë, duke shtuar plus 16.000 lekë të trajtimit ushqimor”, - sqaroi ministri Peleshi.

Më tej ministri Peleshi tha se: “Majorit, nga 68.800 lekë, paga i shkoi në 89.440 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 107.000 lekë pa trajtimin ushqimor. Diferenca në pesë vite është 38.200 lekë.

Koloneli në 2019 paguhej 110.000 lekë, shkoi në 143.000 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 163.500 lekë pa trajtimin ushqimor. Gjenerali e ka patur pagën 127.500 lekë në vitin 2022, shkoi në 165.000 lekë pas rritjes me 30% dhe sot shkon në 190.000 lekë. Pra një rritje prej 62.500 lekësh”, - theksoi ministri Peleshi.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi theksoi se qeveria ka rritur buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes në 2% të GDP, duke e bërë Shqipërinë një nga 22 vendet aleate në NATO, që përmbushin angazhimin e Aleancës. Dhe sipas z. Peleshi, në buxhetin e pagave lëvizën 11 milion dollarë, duke patur parasysh që edhe personeli civil do të ketë rritjen e pagave. Ministri i Mbrojtjes bëri të ditur se rritje pagash do të ketë edhe personeli zjarrfikës, i cili sipas tij bën një punë shumë të rëndësishme, të pazëvendësueshme dhe të çmuar. Kjo rritje, sipas tij shkon deri në 30% në varësi të gradave: “Asistent zjarri, që



është grada më e ulët e zjarrfikësit, paga aktuale është 46.000 lekë, rritet në përqindje 30.43%, në vlerë 14.000 lekë, paga sot shkon në 60.000 lekë. Sapo hyn në Shërbimin Zjarrfikës, paga fillestare nga sot do të jetë 60.000 lekë. Zjarrfikësi, një gradë më e lartë, ka pasur pagën 52.500 lekë, sot shkon në 65.000 lekë; kryezjarrfikës nga 55.000 lekë shkon në 70.000 lekë; kryeinspektor zjarrfikës nga 74.500 lekë shkon në 85.000 lekë; inspektor zjarrfikës nga 64.200 lekë shkon në 75.000 lekë; komisar zjarrfikës nga 97.500 lekë shkon në 105.000 lekë; drejtues zjarrfikës nga 108.000 lekë shkon në 115.000 lekë; drejtues i parë zjarrfikës nga 120.000 lekë në 140.000 lekë dhe drejtues i lartë zjarrfikës nga 131.000 lekë shkon në 160.000 lekë”, - specifikoi ministri Peleshi, duke i cilësuar si nivele shumë dinjitoze pagash.

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, pjesë e takimit të zëvendësshefave të SEDM-it, të zhvilluar në Stamboll

Në kuadrin e iniciativës së SEDM-it (South-Eastern Europe Defense Ministerial) kryesuar nga Rumania, në Stamboll u zhvillua takimi i Zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore anëtare të SEDM-it, ku Turqia ishte në rolin e vendit pritës. Ky është një takim i përvitshëm, që ka për qëllim për të promovuar bashkëpunimin konstruktiv ushtarak rajonal në Evropën Juglindore (EJL), me qëllim të rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit, stabilitetit, besimit dhe sigurisë në rajon e më gjerë. Vitin e kaluar ky takim u zhvillua në Romë të Italisë.

Në këtë takim morën pjesë zëvendësshefat e Shtabit të Përgjithshëm nga shtetet anëtare të SEDM-it. Republika e Moldavisë ishte pjesëmarrëse për herë të parë, jo më si vëzhguese, por si anëtare me të drejta të barabarta e kësaj iniciative.

Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Kapiteni i Rangut të Dytë Bedo Merruko, oficer shtabi në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, gjeneral İrfan Özsert, në rolin e vendit pritës, iu uroi mirëseardhjen në takim të gjithë pjesëmarrësve. Pastaj fjalën e mori drejtuesja e takimit, nga Rumania, znj. Violeta Nicolescu, drejtoresha e Sekretariatit të SEDM, e cila, pasi falënderoi vendin pritës për organizimin e takimit, vlerësoi arritjet e kësaj iniciative dhe përgëzoi pjesëmarrësit për punën e bërë dhe finalizimin e “Deklaratës së Përbashkët” (Joint Statement).

Takimi vijoi me hapësirën për deklaratat e vendeve pjesëmarrëse të iniciativës për dhënien e qëndrimeve të tyre politiko-ushtarake për situatën e sigurisë rajonale dhe më gjerë. Gjatë dhënies së deklaratave të vendeve pjesëmarrëse u vu re se të gjitha shtetet dënuan agresionin e Rusisë dhe mbështetën unanimisht integritetin territorial të Ukrainës. Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së të Republikës së Shqipërisë, gjeneralmajor Manushaqe Shehu në fjalën e saj, pasi falënderoi vendin pritës për organizimin dhe ecurinë e iniciativës nën drejtimin e Rumanisë (2023 – 2025), shprehu vendosmërinë e FARSH-së dhe Republikës së Shqipërisë për vijimin e bashkëpunimit rajonal në fushat e edukimit, trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta. Gjithashtu ajo shprehu qëndrimin e vendit tonë kundër agresionit të përvokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, si dhe vijimin e mbështetjes së Ukrainës deri në sigurimin e plotë të integritetit ter-

ritorial të saj. Gjithashtu ajo theksoi se rajoni ynë është në një rrezik të vazhdueshëm ndaj influencës Ruse dhe si rrjedhojë vendet e rajonit tonë duhet të tregojnë vullnetin e tyre të përbashkët për t'u përballur me sfidat dhe kërcënimet e mundshme.

Më pas Komandanti i SEEBRIG-ut, gjeneral brigade Bilbil Bitri vijoi me pasqyrimin e aktiviteteve kryesore të realizuar nga SEEBRIG, si dhe aktivitetet në vijim që prej marrjes së drejtimit

të SEEBRIG-ut nga vendi ynë prej muajit gusht 2023. Një prej sfidave kryesore të SEEBRIG-ut, e cila është në fokusin e momentit, është integrimi i kësaj strukture me strukturat e NATO-s, duke bashkëpunuar në fushën e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Më pas pjesëmarrësit diskutuan edhe finalizuan “Deklaratën e Përbashkët” (Joint Statement), e cila u miratua unanimisht nga të gjithë pjesëmarrësit.



Në “Deklaratën e Përbashkët” vendet anëtare vlerësuan punën e bërë nën drejtimin e Rumanisë dhe dënuan unanimisht agresionin e vazhdueshëm të Rusisë ndaj Ukrainës. Theksi u vu në bashkëpunimin dhe qëndrimet e përbashkëta ndaj problematikave rajonale si rruga dhe forca e vërtetë e këtij forumi me synimin integrimin euro-atlantik të rajonit.

Takimi i ardhshëm u vendos të zhvillohet në Sofje, Bullgari, gjatë muajit qershor 2025.



U zhvillua ceremonia e certifikimit dhe betimit të rekrutëve

Ceremonia e certifikimit dhe betimit të rekrutëve, të cilët përfunduan me sukses kursin e Stërvitjes Individuale Bazë, është një moment krenarie dhe arritjeje për të gjithë pjesëmarrësit, duke treguar përkushtimin dhe përgatitjen e tyre për t'i shërbyer vendit me nder dhe dinjitet. Urime të gjithë rekrutëve!



Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, pjesë e iniciativës “Dhuro gjak, shpëto Jetë”

Personel pedagogjik dhe kursantë nga Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursi i Lartë i Oficerit, u bënë pjesë e fushatës së dhurimit vullnetar të gjakut, zhvilluar në Qendrën Shëndetësore të garnizonit “Skënderbej”.

Seanca e dhurimit të gjakut u realizua në kuadër të bashkëpunimit të Forcave të Armatosura me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe do të vijojë dhe përgjatë muajve në vijim.



Efektivat e Regjimentit të Këmbësores së Jugut dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë dhe njerëzit në nevojë

Pasi përfunduan me sukses stërvitjen 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët -24”, efektivët e Regjimentit të Këmbësores së Jugut, Poshnjë, Berat, në mbështetje të fushatës së Dhurimit Vullnetar të Gjakut, ditën e djeshme iu bashkuan nismës “Dhuro Gjak – Shpëto Jetë”, për dhurim vullnetar të gjakut, në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në nevojë.

Dhurimi i gjakut për njerëzit në nevojë u krye në bashkëpunim me Bankën e Transfuzionit të Gjakut dhe nën kujdesin e mjekëve të Qendrës Shëndetësore të Forcës Tokësore. Me anë të këtij kontributi, efektivët e Forcës Tokësore solidarizohen me përpjekjet e të sëmurëve që luftojnë për jetën. Kjo nismë do të vijojë në ditët në vazhdim edhe në strukturat e tjera të Forcës Tokësore.





Qendra shëndetësore Rol-1 e BKL-së përfundon me sukses stërvitjen vetëvlerësuese “MEDEVAL”

Në vijimësi të trajnimeve për vlerësimin NATO “MEDEVAL”, Qendra Shëndetësore Rol-1 e BKL-së nën drejtimin e trajnuesve të Gardës Kombëtare të New Jersey-it kreu stërvitjen e vetëvlerësimit. Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte vetëvlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe materialeve mjekësore të Qendrës Shëndetësore Rol-1 e bkl-së, në kuadër të vlerësimit NATO “MEDEVAL”.

Gjatë vetëvlerësimit u testuan aftësitë e personelit mjekësor për dhënien e ndihmës së parë mjekësore, evakuimi i pacientëve nga vendi i dëmtimit në pikën e grumbullimit të të dëmtuarve, evakuimi i të dëmtuarve nga pika e grumbullimit të të dëmtuarve në qendrën shëndetësore fushore Rol-1, triazhimi i tyre, stabilizimi dhe evakuimi për Rol-2 ose Rol-3, në varësi të gravitetit të dëmtimit. Gjithashtu u testuan aftësitë e personelit mjekësor në situatë të jashtëzakonshme; si MASKALL dhe dhënia e ndihmës së parë të dëmtuarve me kontaminime biokimike.

Krahas testimit të aftësive profesionale të personelit mjekësor u vlerësua dhe mënyra e plotësimit të dokumentacionit si: nëntë linjat e evakuimit mjekësor, kartela shoqëruese e të dëmtuarit nga vendi i dëmtimit në qendrën shëndetësore Rol-1, kartela mjekësore e mbajtur gjatë kohës së stabilizimit, si dhe kartela shoqëruese për në nivelet më të larta mjekësore Rol-2 dhe Rol-3.

Personeli mjekësor i QSH-së të bkl-së, gjatë stërvitjes tregoi përkushtim dhe profesionalitet të lartë gjatë zbatimit të detyrave në të gjithë skenarët e improvizuar të stërvitjes.

Trajnuesit e Gardës Kombëtare të New Jersey-it u shprehën të kënaqur nga progresi i personelit mjekësor në dhënien e ndihmës së parë, stabilizimin dhe evakuimin e të dëmtuarve.

Gjatë zhvillimit të kësaj stërvitjeje krahas situatave të improvizuara sipas skenarëve të hartuar nga trajnuesit, në qendrën shëndetësore u zhvilluan vizita mjekësore reale për ushtarakët që patën probleme shëndetësore, si dhe për popullsinë civile të zonës.



93 vjet Mbrojtje Kundërajrore

Plot 93 vjet më parë, Forcave të Armatosura iu bashkëngjit Mbrojtja Kundërajrore.

MKA, si armë e Artilerisë dhe Radiolokacionit, e nisur fillimisht vetëm me 3 bateritë e artilerisë, kryesisht në portet e vendit, u fuqizua ndër vite, deri tek raketat apo radarët.

Si pjesë e Sistemit të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s, (NATINAMDS), MKA sot do të kontribuojë dhe me asetet moderne të vëzhgimit, duke u kompletuar me elementet e Mbrojtjes Ajrore të bazuar në tokë (GBAD), si dhe kompletimi me radarë, në zbatim të projektit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore (SIVHA). Me këtë rast, Komandanti i Faj-së, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, uroi dhe përgëzoi ushtarakët e Faj-së dhe kryesisht ata të Mbrojtjes Kundërajrore për kontributin ndër vite, sakrificat, dhe përkushtimin e tyre.

“MKA ka qenë objektivi i parë dhe kryesor i Faj-së, që kërkonte modernizim dhe përkushtim, në vazhdimësi të misionit fisnik dhe vlerave që FARSH-të dhe FAj mbartin”, - u shpreh ndër të tjerash gjeneral Dimo.



Komanda Mbështetëse, pjesë e Ditës së Vizitorëve të Shquar

Në stërvitjen “Përpyjekja e Përbashkët - 24”, Komanda Mbështetëse angazhoi strukturat dhe personelin, me qëllim sigurimin e mbështetjes logjistike të Forcës së Bashkuar të Organizuar për Detyrë, në zonën e operacionit Bizë dhe vend-dislokim Rrapi i Treshit me kapacitete EOD, xheniere, transport trupash, mjete dhe teknikë, set fushor dhe kapacitete për ngritjen e fushimit. Në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD), në rajonin stërvitor Bizë, toga EOD tregoi kapacitetet teknike (mjete, pajisje EOD) dhe aftësi operationale për zgjidhjen e situatave gjatë stërvitjes.

Toga EOD demonstroi dy skenarë, improvizimin e zjarrit të artilerisë së kundërshtarit, duke realizuar shpërthime të kontrolluara, si dhe mbështetjen me kapacitete EOD, duke bërë të mundur asgjësimin e 13 predhave, mortajë 81mm dhe 5 mortaja 120mm.

Komanda Mbështetëse testoi kapacitetet e saj të mbështetjes logjistike në të gjitha klasat e furnizimit, kapacitetet transportuese, ato të mirëmbajtjes, kapacitete xheniere dhe EOD.



U zhvillua aktiviteti “Rotary Wing Aircraft Maintenance”

Në Bazën Ajrore Farkë, për një periudhë 4 ditore, në bashkëpunim me zyrën e ODC dhe Gardën Kombëtare të New Jersey-it, u zhvillua aktiviteti “Rotary Wing Aircraft Maintenance”.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte familjarizimi me programet e kapaciteteve logjistike të mirëmbajtjes ajrore si pjesë e mbështetjes së operacioneve ajrore. Trajnimi përmbante tema si programet e trajnimit dhe mirëmbajtjes të helikopterëve, zhvillimi i SOP për mirëmbajtjen e helikopterëve, funksionet e mirëmbajtjes të njësive të aviacionit, dislokimi dhe ridislokimi i kapaciteteve të aviacionit, etj. Ky aktivitet do t'i shërbejë Forcës Ajrore për të identifikuar kapacitetet në përputhje me EUCOM CCP LOA dhe standardet e NATO-s.



Anija P-134 “Butrinti” vijon stërvitjen “Përpyjekja e Përbashkët”

Anija P-134 “Butrinti”, si pjesë e stërvitjes “Përpyjekja e Përbashkët”, vazhdon të kryejë detyrën për kontrollin dhe sigurinë e hapësirës detare në zonën e përgjegjësisë së saj në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Sot anija P134 “Butrinti” stimuloi skenarin MIO (verifikim dhe bordim për sigurinë detare) të një anije tregtare, e cila lundronte brenda ujërave tona territoriale. Gjatë verifikimit u zhvilluan të gjitha procedurat sipas standardeve në zbatimin e ligjshmërisë detare.

Gjithashtu është ndjekur dhe një skenar i dytë në hapësirën detare pranë linjës së gazsjellësit TAP-it, në të cilin u konstatua një mjet lundrues tip jaht.

Anija P-134 “Butrinti” është përpjekur për të komunikuar me mjetin lundrues, pasi dyshohej se mjeti po kryente aktivitet të paligjshëm në këtë zonë.

Në momentin e afrimit nga grupi i bordingut drejt jahtit, mjeti filloi lëvizjen me shpejtësi maksimale drejt perëndimit, duke u përpjekur për t'u larguar nga ujërat tona territoriale.

Anija P-134 si dhe gomonia me grupin e bordingut filluan ndjekjen, si dhe kërkuan bashkëpunim nga shteti fqinj për të bërë të mundur bllokimin e tij. Anija P-134 vijon patrullimin në rajonin e saj të përgjegjësisë për sigurinë lundimore dhe hapësirës tonë territoriale detare.



SHSHP, gjeneralmajor Arben Kingji uron efektivin e Shërbimit të Ndërlidhjes me rastin e 93-vjetorit të krijimit

Të nderuar oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe punonjës civilë të strukturave të Ndërlidhjes!

Me rastin e 93-vjetorit të krijimit të Shërbimit të Ndërlidhjes, ju përcjell urimet dhe vlerësimet më të mira për punën dhe kontributin tuaj ndër vite. Që nga krijimi dhe deri në ditët e sotme, strukturat e Shërbimit të Ndërlidhjes realizojnë me sukses misionin dhe detyrat me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë, në mbështetje të komandim - kontrollit në Forcat e Armatosura të Shqipërisë.

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit, i vendos strukturat e ndërlidhjes përpara një sfide shumë të madhe, por jo të paarrtshme. Shpreh bindjen se strukturat tuaja kanë aftësinë e menaxhimit dhe përballimit të këtyre sfidave dhe kjo është e evidente, jo vetëm në rritjen e gatishmërisë teknike dhe operacionalitetin e SNI-ve, por edhe në arritjen e standardeve të ndërveprueshmërisë me strukturat e NATO-s, vendet anëtare dhe partnere.

Me vijimin e implementimit të programeve të modernizimit dhe zhvillimit të SNI-ve në FARSH, strukturat e ndërlidhjes po rrisin aftësitë intelektuale dhe kapacitetet teknike për të realizuar detyrat në mbështetje të komandim-kontrollit në FA. Rezultatet e arritura janë shprehje e përpjekjeve, vetëmohimit, sakrificave, këmbënguljes dhe mendjes së brezave të oficerëve, nënoficerëve, civilëve dhe personelit inxhinier ndër vite, të cilët kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në interes të shfrytëzimit me efikasitet, të zhvillimit dhe modernizimit të Sistemit të Ndërlidhjes dhe Informacionit në FA.

Me këtë rast, ju përcjell të gjithëve vlerësimet më të larta dhe ju garantoj se do të keni mbështetjen maksimale në rugën e përbashkët drejt vazhdimësisë së misionit tonë të shenjtë. Gëzuar festën e 93-vjetorit të Krijimit të Shërbimit të Ndërlidhjes!

Suksese të mëtejshme në realizimin dhe përmbushjen e detyrave tuaja!



Kontributi humanitar i trupave xheniere, vlerë e shtuar e FA-së

1 korrik 1968, krijohet Brigada Xheniero-Ndërtuese, edhe pse kontributi i saj është më i hershëm, ajo daton me 20 janarin e vitit 1921, ku me vendim të qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua kompania e parë xheniere në përbërje të Divizionit të parë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse. Më datën 24. 6. 1928, për herë të parë u krijua Komanda e Trupave Xheniere. Në vitin 1929 numëroheshin gjithsej 10 nënrepartet xhenierë. Gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, nga njësitë partizane u përdorën shumë elementë të sigurimit xhenier e të luftës me mina, edhe pse strukturat xheniere të paralufës ishin shpërberë.

Më 10 prill të vitit 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇ-së, urdhëroi ngritjen e skuadrave të para minatore, të cilat i dhanë një efikasitet të madh veprimeve luftarake të njësive, duke hedhur kështu bazat e ngritjes së strukturave xheniere pas çlirimit të vendit. Në korrik të vitit 1945, u krijuan nënrepartet xheniere në divizione dhe njësia e parë xheniere, e cila u vendos në Elbasan. Në vitet më vonë, repartet e njësive xheniere u rritën e u modernizuan, duke krijuar njësi të reja si Brigada e Urave në Kavajë, Brigada e Xhenios në Tiranë, si dhe tre Regjimentet Xhenierë, që merreshin kryesisht me ndërtimin e objekteve mbrojtës me përmasa të mëdha, si bazat detare Porto Palermo e Shëngjin, baza ajrore Gjadër, objektet në Poliçan, Mjekës, Gramsh etj. Aktualisht, struktura e trupave xheniere është një batalion xhenier, në përbërje të Komandës Mbështetëse, me këtë strukturë: komanda e shtabi, toga e ruajtjes, toga mbështetëse, kompania e ndërtimeve, nënreparti EOD-i, toga e urave.

Kontributi humanitar i trupave xheniere

Ai filloi menjëherë pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë me çminimin e bregdetit të minuar nga pushtuesit nazistë në ikje, nga Currilat deri te Karpeni i Kavajës, me një gjatësi rreth 20 kilometra. Minime ishin kryer gjithashtu në portin e Shëngjinit, në Portin e Vlorës, në Gjirin e Semanit, të Sarandës, dhe në shumë qafa malesh e luginë. Jeta ishte e rrezikuar dhe vdekja trokiste kudo ku shkelte këmba e njerëzve të pafajshëm, që donin të ndërtonin jetën e tyre pas një lufte shkatërrimtare. Kishte ura e rrugë të shkatërruara, banesa dhe godina të rrafshuara. Në këto kushte të vështira xhenierët e batalionit të parë minator çminuan rreth 200 mijë mina kt e kk, së bashku me RIXh të krijuar në Elbasan.



Repartet xheniere ishin të pranishëm pas luftës në rindërtimin e urës së Kuçit, mbi lumin Osum, të urës së Semanit, të urës së Vjosës, urës së Matit, të Dragotit dhe Leklit në Tepelenë e shumë ura të tjera. U ndërtuan me dhjetëra ura mekanike "Bejli" të ardhura ndihmë nga UNRRA, si shpërblim për luftën e bërë ndaj nazifashistëve dhe si vend i dëmtuar shumë në Luftën e Dytë Botërore. Dhe vazhdoi pastaj pa pushuar asnjëherë me ndërtimin e rrugës Kukës-Peshkopi, Gramsh-Lozhan, Çorovodë- Frashër, dhe më vonë në rrugën e Malësisë së Madhe. Xhenierët kanë qenë të pranishëm në tharjen e kënetave, në ndërtimin e kanaleve të mëdhenj



bonifikues, në ndërtimin e pritave dhe argjinaturave, të hidrovorëve dhe ujësjellësve, kudo ku kishte nevojë vendi.

Trupat xheniere nuk pushuan kurrë së vepruari në ndihmë të komunitetit për kapërcimin e fatkeqësive natyrore, në raste përmbytje, zhbllokimit e rrugëve nga dëbora, eliminimin e pasojave të tërmeteve të rënë në Dibër, Tepelenë, Sarandë, e veçanërisht në Shkodër e Lezhë, ku dëmet ishin katastrofike, kontributin e dhënë nga xhenierët për fikjen e pusit të naftës e të gazit në Marinëz, në vitin 1974 etj. Pas viteve '90, në kushtet e ndryshimeve të mëdha demokratike në vend dhe në rajon, trupat xheniere, hoqën dorë nga punimet fortifikuese dhe u hodhën me vull në punime kryesisht në ndihmë të komunitetit si ndërtimi i një segmenti rrugor në Unazën e madhe të Tiranës, ndërtimi i fshatit Bulqesh, Kamëz, ndërtimi i ujësjellësit në Shupenzë etj.

Një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës në rrugët kryesore të vendit dhe me volum të madh punimesh janë: zgjerimi i rrugës kombëtare Llogara-Palasë në vitin 2000 (rreth 12 km), zgjerimi i rrugës kombëtare Bogovë-Çorovodë në vitin 2001 (19.5 km), ndërtimi i rrugës kombëtare Qafë Mejdani - Qafë Morinë në vitin 2002 (rreth 7.7 km), ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen, pjesë e Aksit Durrës-Kukës-Morinë në vitin 2003-2005 (10.5 km), zgjerimi dhe asfaltimi i segmentit rrugor Kthesa e Dajtit-Qafë Mollë në vitin 2005 (5.5 km), në interes të projektit të shkatërrimit të lëndëve kimike etj. Pjesëmarrja në emergjencat civile ka qenë një tjetër medalje e shkëlqyer e trupave xheniere, krahas strukturave të tjera të FA-së, si zhbllokimi i rrugëve nga dëbora gjatë dimrit (dimri 2011-2012), eliminimi i pasojave nga përmbytjet, veçanërisht ajo e Shkodrës dhe Lezhës, ndërtimi e përmirësimi i shumë rrugëve në zonat rurale të vendit etj.

Ndër punimet më kryesore përmendim: Gërmim shkëmbi dhe dhera të ndryshëm rreth 21638 m3, ngarkim e transport dherash e zhavorri 5862 m3, përhapje e nivelim dherash e zhavorri 15265 m2, rulim shtresë zhavorri 6590 m2, prishje strukturë betoni 103.5 m3, punime betoni M-200, 64,2 m3, punime suvatimi 412 m2, ndërtim muri 15,9 m3, punime bojatisje 3682.5 m2, ngarkim e shkarkim materialesh të rëndë me vinç, 91 orë pune, ndriçim natën me agregat ndriçimi 25 orë pune, shtresë asfalto-betoni 1610

m2 etj. Punimet e kryera nga batalioni xhenier janë të shumta e të shumëllojshme. Nuk ka zëra pune që forcat dhe mjetet e tij të mos kenë kryer. Kjo falë edhe strukturës efikase të këtij reparti, por edhe të kapaciteteve të konsiderueshme inxhinieroteknike dhe specialistëve që disponon, organizimit dhe drejtimit me rendiment të punëve nga komandanti dhe shtabi i batalioni dhe të nënrepartëve të tij. Në zbatim të VKM-së Nr. 931, data 09.10.2013, "Për krijimin e Task-Forcës për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente për mbrojtjen mjedisore dhe rehabilitimin e territorit", batalioni xhenier është angazhuar në 14 objekte për pastrimin e mbeturinave inerte të krijuara nga ndërtesat e prishura dhe sistemimin e ambienteve, si dhe në realizimin me sukses dhe pa aksidente të rrëzimit të ndërtesave, ku janë angazhuar 161 forca, 37 mjete dhe 8 agregate xhenierë. Në këto angazhime, xhenierët kanë demonstruar profesionalizëm, disiplinë të lartë dhe ndjenjë sakrifice. Nuk kanë munguar gjatë vitit 2014 edhe ndërtimi dhe riparimi i urave "Bailey", kaq të nevojshme nga komuniteti, veçanërisht ai rural, ku nevojat janë të shumta. Janë ndërtuar ura mekanike "Bailey në 4 komuna, ku janë angazhuar 43 forca, 19 mjete të ndryshëm dhe 3 agregate, me një gjatësi të urave të ndërtuara 68 metra dhe ura të riparuar 15 metra.

Operacionet në komunitet janë për ne "ura komunikimi", midis ushtrisë dhe popullit, sepse ato e kanë prezantuar nga afër fytyrën humanitare të FA-së, i kanë bërë ato më të dashura dhe më të pranueshme. Forcat dhe mjetet e batalionit xhenier ishin ndër të parët që u gjendën pranë komunitetit edhe në rastin e emergjencës së përmbytjes në Qarkun e Lezhës nëntorin e kaluar, ku edhe në këtë rast ato demonstruan qëndrueshmëri, profesionalizëm dhe rendiment në punë, në pastrimin e segmenteve rrugorë, transportimin e materialeve inerte për bllokimin e ujërave etj. Në batalionin xhenier bën pjesë edhe nënreparti EOD-i, i specializuar dhe certifikuar nga NATO, për kryerjen e operacioneve speciale për çminim dhe asgjësimin e municioneve, i cili gjatë këtyre viteve ka kryer me qindra operacione në të katër anët e vendit, duke vënë edhe jetën në rrezik. Një tjetër nënrepart xhenier i konsoliduar dhe me vlera të veçanta është edhe kompania xheniere e luftimit, në përbërje të FT-së, e cila merr pjesë në përbërje të SEEBRIG-ut, Brigada e Europës Juglindore. Shfrytëzoj rastin për të falënderuar të gjithë punonjësit, ushtarakë e civilë, që kanë derdhur dhe derdhin djersën dhe mundin e tyre për të realizuar me sukses detyra me ngarkesë të lartë fizike dhe psikologjike dhe kanë ngritur lart emrin e xhenierit në vite. Xhenierët kanë edhe dëshmorët e tyre. Në këtë ditë të shënuar kujtojmë me respekt kolegët tanë xhenierë që dhanë jetën e tyre për një vend të pastër nga minat e municionet e ndryshme vdekjeprurëse, që nga dëshmorët e parë xhenier, kapiteni Panajot Haxhimihali, e deri te ata të ditëve tona, siç janë oficerët Nuredin Gorçe, Aqif Karaj, Mehmet Hysa, Flamur Radani, dhe traktoristi Petrit Uku e Ilir Malçi, të cilët janë shembull frymëzimi për xhenierët.

E kush më mirë se njerëzit që kanë qenë pjesë e këtyre strukturave, drejtues apo specialistë, që kanë kontribuar një jetë me dinjitet si pjesë e FA-së, do të mund të sillte për brezat një historik të aktivitetit të njerëzve në uniformë, një prej të cilëve dhe z. Përparim Velu, i cili ka pasqyruar një histori suksesi disa dekadash.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Jetojmë në shekullin e “çmendurive” të mëdha të zhvillimeve teknologjike, që së bashku me risitë sollën dhe problematikat sociale, të cilat sa vjen dhe bëhen të pariparueshme. Dhe në këtë vorbull gjenden prindërit përballë fëmijëve dhe rrezikut të jetës së tyre. Shpesh prej tyre dëgjojmë: Është kohë tjetër o ma! Ti nuk mund të më kuptosh se në kohën tënde ka qenë ndryshe...

Në kohën time?!

Çudi, shpesh më duket se vij nga shekulli “xixë” nuk di ta përshtat moshën, natyrën, jetën time me një stad të caktuar kohor.

Kohë e pa kohë / A dimë të prindërojmë?



Ky telefon i përket djalit tim 18 vjeç. Po mbushet mbi kabinetin e kuzhinës sime. Në orën 9 të mërkurës, çdo natë, telefoni i tij fikej, vetë ai e sillte këtu.

Pse? Kjo ishte mënyra ime për ta mbajtur atë të sigurt.

Ky telefon nuk kishte rrjete sociale, ai kishte një aplikacion, që i mundësonte të bisedonte me miq dhe familjarë. Unë i njihja të gjithë ata me të cilët ai fliste dhe i kontrolloja mesazhet rregullisht.

Pse? Sepse kështu e mbaja atë të sigurt.

Djali im kur mbushi 12 vjeç më pyeti nëse mund t’ia lidhja PS4 me internet që të mund të luante me miq jashtë shtëpisë. I thashë jo.

Ai kishte disa argumente bindëse dhe tha disa gjëra me të cilat pajtohesha. Por për fat të keq, këto anë të mira përsëri nuk kanë më shumë peshë sesa anët negative. *Pse? Kështu e mbaja atë të sigurt.*

Këto pajisje, kur i lëmë pa kontrollin tonë u lejojnë njerëzve të tjerë të hyjnë në shtëpitë tona në çdo moment. Nuk i iket kësaj. E unë këtë shtëpi e kam ndërtuar si strehë për fëmijën tim. Është një vend i sigurt për fëmijën tim. Pavarësisht se çfarë ndodh atje jashtë në botë, unë dua që kjo shtëpi të jetë vend-pushimi i tij, streha e tij e sigurt, kështjella e tij.

Hapja e derës për qasje të pakufizuar në internet, i lejon çdokujt të hyjë në shtëpinë tonë. Unë këtë derë e mbaj mbyllur. Kur bëhet fjalë për qasjen në internet, ka zero privatësi. ZERO. Kam dëgjuar shumë argumente në lidhje me privatësinë dhe akoma nuk e kam dëgjuar asnjë që të më bëjë ta rimendoj sigurinë e fëmijës tim.

Ne nuk na takon ta ruajmë vetëm sigurinë e tyre fizike. Ne duhet t’i ruajmë zemrat e tyre, sytë dhe veshët e tyre deri sa të jenë të aftë t’i bëjnë zgjedhjet e veta racionale. Në këtë çështje, unë jam mami e rreptë, mami që nuk “kuptoj”.

Pse? Sepse kam lexuar pa fund rrëfime të prindërve që do të

Prindërimi, sfida e të gjitha kohërave



dëshironin të zhbënin atë që është bërë. Ka fëmijë - po, FËMIJË - që u dërgojnë fotografi, video dhe përmbajtje të tjera seksuale “miqve” të tyre online. Dhe kjo nuk po ndodh diku atje larg. Po ndodh në familje të mira, solide, me vlera e edukatë familjare. Po ndodh para syve tanë. Rezultatet e kësaj krize akoma mbeten të shihen.

Djemtë tanë janë të ekspozuar ndaj përmbajtjeve seksuale dhe pornografisë shumë vite më herët sesa kanë qenë baballarët e tyre dhe pasojat janë të pamatshme.

Prindër, edukohuni në lidhje me dëmet afatgjata të ekspozimit të të rinjve ndaj pornografisë. E di se më të moshuarit mund ta marrin guximin ta arsyetojnë këtë, duke thënë “Hajt se djem janë...”. Kotësi! Ne po tolerojmë sjellje devijante, duke supozuar thjesht se kjo është çfarë djemtë bëjnë. Më nuk bëhet fjalë për fotografi revistash të vajzave që asnjëherë nuk mund t’i takojnë. Bëhet fjalë

vazhdoni ta bëni punën tuaj si prind. Sot djali im është 18 vjeç, ne si prindër bëme gjithçka që ai të mos dëmtohej gjatë rrugëtimit të tij, tashmë ai është në gjendje të bëjë dallimin e madh mes përkushtimit pa kushte të prindërve të tij dhe “urrejtjes” të tij, kur kishte në çdo hap që hidhte, dy shqiponja vigjilente.

Asnjëherë fëmijët nuk do e pranojnë “survejimin” prindëror, sepse duan “privatësi”, e cila në moshat e reja është e rrezikshme.

Të dashur fëmijë!

Besoni këshillat e prindërve tuaj, pasi ata janë njerëzit e parë që ju duan pa kushte, dëgjoni këshillat e tyre dhe kritikën e tyre. Jo gjithmonë kritikën e prindërve janë ato që ju ulin rolin tuaj apo duan t’ju tregojnë se ju jeni më të vegjël, jo gjithmonë ndodh kështu. Janë ata që duan të krijojnë një vetëbesim tek ju, janë këto kritika që duan të krijojnë një personalitet të fuqishëm, janë kritika që duan t’ju rrisin ju në mendësi, kulturë, që ju të bëheni një qytetar i mirë, njerëz më të mirë. Besojini prindërve tuaj, motrave dhe vëllezërve tuaj, sepse ata janë njerëzit që duhet t’ia besoni problemet tuaja. Mos i tregoni problemet tuaja jashtë rrethit familjar, sepse të tjerët mund ta keqpërdorin këtë informacion, dhe mund t’ju bëjnë të ndjeheni keq. Dëgjoni kritikën dhe mos mendoni se prindërit ju kritikojnë se duan t’ju ulin apo t’ju zhgënjajnë, përkundrazi prindërit ju kritikojnë, sepse duan që të rrisin një adoleshent të shkëlqyer dhe duan që adoleshenti i tyre të bëhet një njeri me norma dhe parime, një qytetar i lirë dhe me vetëbesim, me mendje të bukur, një qytetar i edukuar e i kulturuar. Prandaj besojini gjithmonë prindërve, janë të vetmit që ju duan më lart se veten!

Dilemë prindërore

Shumë prindër pyesin veten, a janë prindër të mirë apo jo. Në të vërtetë fëmijët nuk kanë nevojë vetëm për prindër të përsosur, por të arritshëm në jetë. Për t’u rritur, adoleshenti ka nevojë të ndërtojë identitetin dhe bindjet e veta, kjo është edhe arsyeja përse ata në këtë moshë i kundërshtojnë prindërit.

Në këtë moshë ata dëshirojnë që t’i lejojnë të krijojnë bindjet e tyre. Kanë dëshirë që të provojnë gjëra të reja, në veçanti nëse këto janë të ndaluara dhe emërtohen si të “keqija” nga të rriturit.

Nuk është qëllimi i tyre që të shkelin rregullat, por e rëndësishme është që ky rregull të shoqërohet me një shpjegim. E mira është të flisni me fëmijën tuaj për këto tema sociale që ju shoqërojnë, por pa qenë moralizues. Adoleshentët kanë nevojë të marrin informacione dhe së bashku me prindërit mund të diskutojnë për këto tema delikate.

E megjithatë misioni ynë është të mos lejojmë të bien dhe nëse ndodh, dora jonë të jetë e shtrirë për ta, për t’i ringritur fuqishëm në botën e çudirave të mëdha, me të cilën po përballen çdo ditë.



për fotografi të zhveshura të vajzave me të cilat takohen në shkollë çdo ditë. Kjo nuk është përpjekje për të mbjellë frikë, as prindërim paranojak.

Kontrollojini telefonat!

Kontrollojini çfarë bëjnë online. Nëse i lejoni të përdorin rrjete sociale, sigurohuni që të jeni ndjekësi i tyre më i rregullt. Fëmijëve me gjasë nuk do t’u pëlqejë ky veprim, do të kundërshtojnë. Ju

Atdheu përjetë mirënjohës!



ELIDIANA CANAJ
Docente Dr. në Sociologji*

Festohet 80-vjetori i Brigadës XV Sulmuese partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Pogradec

Me ftesë të bashkisë, u mbledhëm në qytetin e Pogradecit për të festuar 80-vjetorin e krijimit të Brigadës XV Sulmuese, partizanë të ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare. Autoritetet e qeverisjes vendore dhe përfaqësuesit e institucioneve politike lokale e rajonale, veç detyrimeve ligjore, mbajnë gjallë kujtesën kolektive dhe respektojnë edhe detyrimet morale në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë së lavdishme historike, në nivel lokal-rajonal në territoret nën juridiksionin e përgjegjësive të tyre. Bashkia e Pogradecit, në kalendarin e festave për nderimin e ngjarjeve të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, kishte programuar festimet e krijimit të brigadës XV Sulmuese.

Si pasardhës e konsideruam sfidë pjesëmarrjen me dinjitet në këtë përvjetor! Ne nuk e kemi privilegjin e luftëtarëve të lirisë! Ne nuk jemi protagonistët e pritave dhe luftimeve e fitoreve mbi pushtuesin! Por kemi privilegjin të jemi pasardhës të tyre, “titull” e “nder” që duhet ta meritojmë me qëndrimet tona, në përbushje të detyrave e përgjegjësi tona qytetare atdhetare!

Vlerat e historisë së LANÇ-it dhe fitoret e arritura mbeten gur themeli për Shqipërinë dhe nuk i përkasin një brezi e as disa individëve. Doemos kontributet duhen analizuar në hapësirë e në kohë, në raport me kushtet e përgjegjësitë konkrete. Sot dhe në takimet e përvjetorëve të tjerë do të rritet madhështia e veprës së çlirimtarëve antifashistë! Ne dhe pasardhësit e njëpasnjëshëm kujtojmë me përvëlje e respekt luftën dhe sakrificat e tyre dhe kemi të drejtë të legjitimojmë krenarinë për veprën e tyre dhe njëherazi përgjegjësitë tona në mbrojtje të fitoreve, në mbrojtje të vlerave për Liri, Pavarësi dhe Progres.

Çdo brez ka se çfarë të mësojë nga paraardhësit e vet e çfarë duhet t'u përcjellë pasardhësve. Prindërit tanë, po të jetonin, nuk do të ishin më të rinj se 95 vjeç. Ishte në sallë vetëm një veteran në moshën 97 vjeç. Patëm një kompleks ndjenjash në këtë përvjetor: dhimbje për mungesën fizike të prindërve e të afërmeve tanë. Krenari që vepra e tyre rron me Shqipërinë e lirë e antifashiste! Krenari për arritjet në këta 80 vjet! Përgjegjësi për të merituar cilësimin e pasardhësit të luftëtarëve për liri, antifashizëm e Progres!

Atdhetarizmi ka kuptim e peshë konkrete në çdo periudhë e për çdokënd në detyrat që kryen. Gjithkush duhet të dëshmojë e t'i kontribuojë me dinjitet identitetit Shqiptar.

Mbërritëm pak para se të fillonin ceremonitë në Pogradec, por, tek lapidari, simbol i brigadës XV Sulmuese, “na pritën” këngët partizane! Lapidari ishte i bukur mes gjelbërimit me sfond Liqenin. Ishte i pastër, i mirëmbajtur dhe në krye valëvitej një flamur kombëtar.

Mbas nesh mbërritën n/kryetarja e Bashkisë, zonja Entela Gusho, drejtuesi i PS për Pogradecin. Erjon Thengjilli, n/prefekti i Qarkut të Korçës, Luan Maxhari, përfaqësues nga Këshilli i Qarkut të Korçës, nga organizata e Familjeve të Dëshmorëve, shoqatat kulturore të krahinës dhe një numër i madh nga pasardhësit e veteranëve të Pogradecit.



Nën tingujt e marsheve partizane u vendosën kurorat me lule të freskëta. Bashkia ishte kujdesur të vendosë një kurorë nga përfaqësuesit e pasardhësve të partizanëve, dëshmorëve të LANÇ-it e Heronjve të Popullit të brigadës. Kjo kurorë u vendos nga djali i Komandantit Flori Teki Kolaneci dhe nga Elidiana Murat Abazi Canaj.



Pse u krijua Brigada XV S?

Ishte situatë e vështirë lufte. Pushtuesit organizuan operacionin e dytë për të asgjësuar ushtrinë Nacionalçlirimtare në Shqipëri, për të shtypur lëvizjen popullore antifashiste. Reaksioni dhe tradhtarët vendas kishin dalë hapur në krahun e pushtuesve.



Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm u veçuan partizanë nga batalionet “Hakmarrje”, “Fuat Babani”, “Reshit Çollaku”, “Skënder Çaçi”, “Rinia”, “Tomori”, që vepronin në Qarkun e Korçës dhe u grumbulluan në Protopapë për të krijuar Brigadën më të re të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në krijimin e brigadës ishin 750 partizanë e partizane gjithsej, nga të cilët 53 ishin vajza. 29 Qershor 1944, shënoi krijimin e brigadës XV, ditëlindjen e saj.

Ishte ky një hap tjetër i rëndësishëm që vërtetoi vlerësimet e Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë se “Sa herë që okupatori dhe shërbëtorët e tij janë përpjekur të zhdukin Ushtrinë tonë Popullore, kjo jo vetëm që nuk është shkatërruar ose dobësuar, por është bërë gjithnjë më e fortë, më e regjur, më e organizuar”. Epërsia e organizimit, dhe e luftës antifashiste u vërtetua edhe nga përgjigja shkatërruese që forcat e ushtrisë Nacionalçlirimtare i dhanë operacionit të qershorit. Në këtë operacion pushtuesit angazhuan 4,5 divizione gjermane dhe disa mijëra vetë të bandave të armatosura të “Ballit Kombëtar” e të “Legalitetit”. Armiku kishte varur shpresa të mëdha, por manovra rrethuese dështoi! Ushtria jonë e goditi armikun dhe kudo dha prova zotësie, organizimi dhe heroizmi më tepër se kurrë. “Në zjarrin e operacioneve, me gjakftohtësinë metodike, u mbarua organizimi i një brigade të re, Brigadës XV, që po hyn në radhën e brigadave tona heroike”.

Komandant i Brigadës u emërua Teki Kolaneci/Hero i Popullit, Komisar - Shahin Ruka, zëvendës komisar - Vaskë Koleci, përgjegjës i sektorit politik - Myftar Tare, përgjegjës i propagandës - Misto Treska, përgjegjës i rinisë - Minella Trebicka, intendenti i brigadës - Sabri Dajlani. Kuadro me eksperiencë dhe rol të spikatur ushtarak e politik kishte edhe në drejtimin e batalioneve, kompanive e skuadrave, ndonëse të gjithë luftëtarët vepronin si një trupë kompakte e suksesshme.

Brigada XV çliroi një territor prej 4000 m² dhe iu dha lirinë qyteteve Pogradec, Elbasan, por kontribuoi edhe për çlirimin e kryeqytetit. Ka goditur vazhdimisht kolonat armike në rrugët: Korçë - Strugë dhe Elbasan - Tiranë. Ka mbyllur forcat gjermane në fortifikata në: Korçë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Çervenakë, Qafë Thanë, Përrenjas, Qukës, Xibrakë, Kaçolitë (Kërrabë) me mbi 3000 ushtarë e oficerë e me armët më moderne të kohës. Shpartalloi dhe çarmatosi mbi 2000 forca xhandaro - balliste. Kreu 37 aksione kryesore. Vrau mbi 533 ushtarë e oficerë gjermanë e kapi 72 robër. Shkatërroi 200 makina e 4 tanke e autobllinda. Zuri trofe 36 topa, mortaja e mitraloza të ndryshëm si edhe sasi të mëdha municioni. Dhanë



jetën 50 dëshmorë e u plagosën 73 partizanë e partizane.

Ceremonia e rastit u zhvillua në shtëpinë e Kulturës.

Edhe këtu “takimi” i parë ishte me një fotoekspozitë në holl dhe me këngët partizane të interpretuara nga këngëtarë e instrumentistë të qendrës multi-kulturore të Pogradecit. Mbasi

u sistemuan të pranishmit, u ekzekutua Hymni Kombëtar. U ngjiti në skenë Entela Gusho. Përhëndeti pjesëmarrësit për mirëseardhjen dhe uroi këtë përvjetor. Solistët e qytetit interpretuan dy këngë partizane.

Në emër të pasardhësve të partizanëve, dëshmorëve të LANÇ-it dhe Heronjve të Popullit të brigadës XV Sulmuese përhëndeti Flori Teki Kolaneci. Fjala e tij u mirëprit dhe u duartrokoi me respekt.

Përhëndeti profesor Maqo Lefter Lakrori. Ndër të tjera ai theksoi se ai brez nuk u mjaftua me kontributin historik të çlirimit nga pushtuesit

nazifashistë e tradhtarëve të vendit, por i kontribuoi rindërtimit, ruajtjes dhe fuqizimit të Shqipërisë, zhdukjes së analfabetizmit dhe rritjes e fuqizimit të sistemit arsimor shkencor akademik, arritjeve në kulturë, shëndetësi, në përmirësimin e nivelit të jetesës, kujdesin për njeriun e rritjen demografike në të gjithë treguesit, në ekonomi, në industrializimin e vendit.... U arritën fitore e suksese të pakrahasueshme. Si pasardhës u jemi mirënjohës për veprën që lanë pas dhe kemi detyrë ta çojmë më tej!

Përhëndeti nipi i dëshmores Thomaidha (Tomka) Laçka. Në luftë mjaft familje kishin më shumë se një partizan. Kështu ka qenë edhe në familjen e babait tim këtu në Pogradec.

Më pas, unë zgjodha të përcjell tek të pranishmit fragmente nga një shkrim i komisarit të brigadës Shahin Ruka, publikuar më 27 gusht 2010. Shkrimi ishte një tablo e qartë me dinamikën e veprimeve luftarake, vendosmërinë, heroizmin e luftëtarëve të Brigadës XV për çlirimin e qytetit të Pogradecit, mbështetjen e pritjen nga populli patriot i qytetit dhe rrethinave. Sulmi filloi i përqendruar me të gjitha formacionet e brigadës njëherësh, më 21 korrik 1944, dhe, me luftime të ashpra, qyteti u çliroi, më 30 gusht 1944. Falënderova të gjithë të pranishmit, organizatorët e pritësit në këtë veprimtari dinjitoze, duke ritheksuar nevojën e edukimit të brezave me vlerat e vërteta të historisë së LANÇ-it. Të jemi më të besueshëm me fakte, dokumente e argumente që brezat të njohin mirë historinë e paraardhësve, të respektojnë historinë e rrënjëve e kulturën etnike, të krenohen me ndërgjegjen

e të marrin përgjegjësi atdhetare, morale e profesionale për të ruajtur e lartësuar sukseset. Puna me brezat duhet të jetë nxitëse, interesante, që në veprimtari të tilla përkujtimore të ulet mosha mesatare e të pranishmëve.

**N/kryetare e Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ të Popullit Shqiptar “Nderi i Kombit”*

Bijë e dy prindërve partizanë të kësaj brigade

IN MEMORIAM

Faleminderit mjeshtër!

I madhi Kadare, ishe njeri, u bërë fjalë, pesha e së cilës nuk ka njësi matëse.

Faleminderit për artin e penës tënde, e cila na prezantoi në opinion botëror si një vend që nxjerr vlera, të cilat potencialisht konkurrojnë me pena që i kanë vënë vulën letërsisë botërore.

Faleminderit që gjuhës shqipe i lëvrove çdo pjesë të saj, për t'i kujtuar çdo skeptiku lashtësinë, vlerën dhe forcën e madhe që ka kjo gjuhë krijuar me njerëzimin.

Faleminderit mjeshtër që në romanet e tua skalite Shqipërinë dhe letërsinë shqipe në kanavacën e letërsisë botërore!

Ismail Kadare

Ismail Kadare lindi në lagjen Palorto në Gjirokastrë, më 28 janar 1936. Në itinerarin e jetës së tij, ai dha kontribute si akademik, politikan, ish-deputet i Kuvendit Popullor (1970-'82), zëvendëskryetar i Frontit Demokratik si dhe një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë.

Si shkrimtar shquhet kryesisht për prozë, por kontributi i tij shtrihet edhe në dramaturgi, poezi dhe përkthime. Nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar. Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe nëpër botë.

Në vitin 1996, Kadare u bë anëtar i përhershëm i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë.


Është nderuar me shumë çmime ndërkombëtare, disa prej tyre janë: Çmimi "Man Booker International"; Çmimi "Prince de Asturias" për Artet; Çmimi "Jeruzalem"; Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit, Kosovë; "Prix mondial Cino Del Duca" Francë; Çmimi "Bokaçio", Itali; "Herder Prize", Gjermani; "Ovid Prize", Rumani; Çmimi "Man Booker International", Britani; Çmimi "Princi i Asturias për Letërsinë, Spanjë; Çmimi "Lerici Pea", Itali; Çmimi "Jeruzalem", Izrael; "Commandeur de la Légion d'Honneur" (C. LH), Francë, 2016; Çmimi "Letërsia shqipe", Kosovë; Çmimi "Nonino", Itali; Çmimi i karrierës akademike, nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Çmimi "Park Kyong-ni", Korea e Jugut; "Neustadt International Prize", SHBA; "Prozart", Maqedoni e Veriut.

Viteve të fundit ai e ndau kohën e tij mes Francës dhe Shqipërisë.

Një korife si Ismail Kadare

Arti i Ismail Kadaresë është i papërsëritshëm, i dimensioneve dhe vlerave të jashtëzakonshme. Duke nisur nga thesari i pasur i gjuhës dhe dialekteve të shkrimeve të vjetra, historia shqiptare, kultura dhe miti, deri te pasuria unike e përvojave, që pa të nuk do t'i përjetonim dhe do t'i mungonin publikut perëndimor. Për shembull, romani i parë i Kadaresë, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", ku pasqyrohet jeta e përditshme e Shqipërisë komuniste me kujtime të historisë së Luftës së Dytë Botërore. Ngjarjet e "Kronikë në gur", të cilat zhvillohen në qytetin e lindjes së Kadaresë, Gjirokastrë dhe shpërfaqin kulturën e veçantë të lagjes në atë mjedis të kufizuar. "Prilli i thyer" na çon në malësinë e Shqipërisë me dukurinë e gjakmarrjes dhe kodet e kanunit, ndërsa "Ura me tri harqe" na sjell Shqipërinë mesjetare, para pushtimit osman, duke i dhënë mundësinë Kadaresë të përsiasë se si do të ishte Shqipëria sikur të mos ishte pushtuar kurrë.

Gjatë fjalimit të Kadaresë në marrjen e Çmimit "Neustadt", ai tha: "Të besosh në letërsi do të thotë të besosh në një realitet më të epërm. Të besosh në letërsi do të thotë se regjimi i errët i vendit tënd duket i zbehtë në krahasim me ritet madhështore letrare të vdekjes. Të besosh në këtë art do të thotë të dish gjithnjë se qeveria që të ka në dorë, policia që të mbikëqyr, parlamenti, shefat, administrata, vetë tirania, janë një makt kalimtar, materie e vdekur, krahasuar me urdhrin e madh ku ti bën pjesë si anëtar i tij". Këtu ai pasqyroi mënyrën se si shkrimtari përdori botën tjetër, magjike të letërsisë, si një mënyrë për t'i shmangur tmerret



e së vërtetës dhe për t'u dhënë atyre një formë të re dhe kuptim të ri në art.

Dimensionet e Kadaresë

Ismail Kadare shpesh ishte bërë pjesë e debateve dhe polemikave ndër vite, më së shumti si një figurë publike në Shqipëri, se nuk ka folur publikisht në një mënyrë apo në një tjetër, se nuk ka qenë

ky apo ai lloj disidenti, se nuk ka qenë gjithmonë një person publik aktiv. Me artin e tij, ai vë në pah nevojën për ta përdorur penën e tij, për të ndërtuar mbrojtje psikike ndaj realitetit.

Pas krizës së vitit 1998 në Kosovë, kur trupat e Sllobodan Millosheviqit bënë spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës, i cili u pasua nga bombardimet e NATO-s në Serbi më 1999, Kadare shkroi "Tri këngë zie për Kosovën". Në vend që të shkruante drejtpërdrejt për tensionet e menjëhershme të së tashmes, ky rrëfim u përqendrua në betejën zanafillore të Kosovës në vitin 1389, ndërsa Kadare përsiat mbi tensionet e panevojshme që u krijuan midis popujve ballkanas për shkak të pushtimit turk. Ky ishte Kadare me optikën përtej së tashmes dhe me mesazh të vështirë për ta gjetur me shfletimin e parë të tij. Arti i Kadaresë, ka aftësinë për të shprehur universalen përmes së veçantës dhe për të shprehur të veçantën përmes universale, letërsia e tij i ka dhënë trajtë njëres prej pikave më të thella të plotësisë së identitetit. Kadare i flet historisë dhe të tashmes vetëm nga pozita e një shkrimtari të madh dhe pikërisht për shkak të kësaj pozite fjalët e tij do të jetojnë në të tashmen, do t'u flasin njerëzve në të gjithë botën dhe do të lexohen për shumë dekada dhe shekuj të ardhshëm.

Vepra e Kadaresë, letërsia e tij e madhe botërore, e lindur në një kohë shtypjeje të tmerrshme në Shqipëri, përkujton atë brez dhe humbjet e tyre. Edhe nëse nuk prek drejtpërdrejt humbjet, edhe nëse autori nuk është disidenti i përkryer, siç nuk ka mëtur kurrë të jetë.

"Pallati i ëndrrave" nuk mund të lexohet ndryshe por vetëm si paraqitje therëse dhe brilante e një sistemi totalitar që kërkon të zhvesh qeniet njerëzore nga liria dhe imagjinata dhe nuk mund të mos kremtosh testamentin e përhershëm të lirisë së imagjinatës siç është vepra e Kadaresë.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Përgatitja për betejën e parë

Skënderbeu ishte mbi të gjitha njohës i Artit Ushtarak shqiptar dhe atij bashkëkohës, osman dhe europian mesjetar. Njëkohësisht, ai ishte njohës deri në detaje i terrenit tipik shqiptar dhe shfrytëzimit me efektivitet të tij gjatë betejave të shumta që ndërmoi në periudhën afro njëzetepesëvjeçare, që e udhëhoqi Ushtrinë e vogël, por fitimtare shqiptare. Po ashtu, Skënderbeu ka qenë një strateg i rrallë dhe vizionar, takticien, novator dhe një mjeshtrë i vërtetë i ndërtimit të formacionit të luftimit të Ushtrisë Shqiptare. Skënderbeu ka merituar vlerësimet e larta të shumë prijësve dhe ushtarakëve bashkëkohës por, sidomos gjatë shekujve pasardhës deri në ditët tona. Gjenerali Xhejms Uollf: “Skënderbeu shkëlqen mes gjithë gjeneralëve të kohëve të vjetra dhe të sotme, si udhëheqës i një ushtrie të vogël mbrojtëse”.

Vendimet historike të Kuvendit apo Lidhjes së Lezhës të 2 marsit 1444, me organizimin e Ushtrisë, rishikimin dhe përforcimin e masave të mbrojtjes së vendit, çlirimin e rajoneve të gjera të Shqipërisë Qendrore e të Sipërme, që formonin një ndër zonat më strategjike të Ballkanit Perëndimor, si dhe bashkimi politik dhe ushtarak i fisnikëve shqiptarë, përbënin ngjarje tejet të rëndësishme, të cilat i kalonin caqet e botës shqiptare të periudhës mesjetare.

Skënderbeu me shtabin e tij, kishte zgjedhur që më herët që, beteja e parë e Ushtrisë Shqiptare kundër asaj osmane, të mund të zhvillohej në fushën e Torviollit, e cila gjendet në Dibër të Poshtme. Ajo është e rrethuar me male e brigje (kodra) dhe pyje, nga të gjitha anët. Torviolli ishte beteja e parë dhe, fitorja e saj, në teoritë e artit ushtarak ka një rëndësi të madhe, sidomos për një ushtri të vogël, si ajo shqiptare e Lidhjes së Lezhës. Prandaj Skënderbeu me gjeneralët fisnikë të tij me përvojë i kushtuan vëmendje të madhe planit për zhvillimin e saj me sukses.

Pjesë e planit për betejën e Torviollit ishte që, me një grup kalorësish, të drejtuar nga vetë Skënderbeu, të merrte kontakt me forcat e ushtrisë osmane që në hyrje të territorit shqiptar. Më tej, të ndërmernte goditje të befasishme të pjesshme mbi kolonat e ushtrisë osmane, kryesisht nëpër prita dhe, në vijim, të tërhiqte forcat osmane, me idenë se forcat e pakta shqiptare ishin të pafuqishme dhe të mundura, duke i ndjellë forcat osmane aty ku ishte parashikuar beteja vendimtare, pikërisht në fushën e Torviollit.

Ndërkohë që ushtria osmane ishte vënë në ndjekje të forcave shqiptare, që tërhiqeshin drejt fushës së Torviollit, ndërsa ruante kontaktin me ta, forcat kryesore të Ushtrisë Shqiptare kishin nisur afrimin sipas planit të parashikuar më parë në fushëbetejë. Sipas të dhënave të hollësishme që sjell në librin e tij M. Barleti, në fushën e Torviollit u afruan forcat kryesore shqiptare, në pritje për t'u rreshtuar sipas planit të betejës, gjithsej 9.000 ushtarë dhe forcat rezervë me 6.000 ushtarë të tjerë.

Skënderbeu e realizoi qëllimin kryesor, për ta ndjellë ushtrinë osmane në drejtim të fushës së Torviollit. Kur tërheqja e forcave të Ushtrisë Shqiptare po i afrohej fundit, Skënderbeu urdhëroi Vrana Kontin të shkëputte kontaktin me trupat e mbulimit dhe, sipas planit të vendosë në fushën e Torviollit, në rezervë, pas formacionit luftarak të forcave kryesore.

Në mbrëmjen e datës 28 qershor, Ushtria shqiptare ishte rreshtuar në fushën e Torviollit sipas planit të betejës. Përballë saj, po rreshtoheshin gjithashtu edhe ushtria osmane, por beteja nisi vetëm në agimin e datës 29 qershor, kur forcat e të dy ushtrive ndodheshin të rreshtuara rishtazi, gati për betejë. Nga pamja e jashtme dukej sikur ushtria osmane e kishte të sigurt fitoren! Të rreshtuar në formacion luftarak ndodheshin 25.000 ushtarë osmanë kundër 9.000 ushtarëve shqiptarë. Për forcat e rezervës, komanda osmane s'kishte asnjë të dhënë. E ndodhur në kushte më të favorshme edhe, në pikëpamje të terrenit, komanda osmane mendonte se e kishte futur Ushtrinë Shqiptare

Dukuri të artit ushtarak të Skënderbeut në Betejën e Torviollit



në një grackë të vërtetë!

Beteja e Torviollit përfundoi me shpartallimin e plotë të ushtrisë osmane. Humbja e rëndë e ushtrisë osmane në Torvioll, ishte jo vetëm humbje e betejës së parë me Ushtrinë Shqiptare, por edhe një paralajmërim serioz për Sulltan Muratin II, se një periudhë e vështirë dhe një kundërshtar i vogël në numër, por i madh dhe i fuqishëm ushtarakisht në fushën e luftës, i priste tashmë. Kjo ishte Ushtria e Shqipërisë së vogël, por me një udhëheqës, strateg dhe komandant të madh, si Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Dukuri të artit të Skënderbeut në betejë

Arsyet dhe argumentet për fitoren e Ushtrisë Shqiptare të Lidhjes së Lezhës në betejën e parë të saj, në Torvioll, pesëdhjetepesë vjet pas betejës së Fushë-Kosovës dhe humbjes së Koalicionit Ballkanas, ishin disa. Ushtria Shqiptare, e re dhe e panjohur, befasoi me strategjinë e ndjelljes dhe mashtrimit të ushtrisë osmane, duke e vënë atë përpara të papriturës dhe detyrimit që ajo të ndeshet në vendin e parapërgatitur nga Skënderbeu në konsultë me komandantët e tjerë, për zhvillimin e betejës vendimtare!

Një tjetër dukuri ishte përzgjedhja dhe studimi paraprak i vendit ku do të zhvillohej beteja, nga ana e Skënderbeut dhe komandantëve të tjerë. Këtij fakti i shtohet padyshim edhe detajimi i planit të saj, si dhe ideimi dhe detajimi i një formacioni efikas, gjë që çoi në një luftim racional, të suksesshëm dhe, tek e fundit fitues të betejës së parë nga Ushtria Shqiptare, krejt e panjohur dhe e nënvlerësuar nga osmanët.

Suksesi i betejës së Torviollit duhet parë edhe nga një pikëpamje tjetër, shfrytëzimi racional i territorit të fushëbetejës. Ky territor ishte relativisht i kufizuar, sipas Nolit, ka shkruar se, “... ishte shtatë milje i gjatë dhe tre mile i gjerë, i rrethuar prej malesh, brigjesh dhe pyjesh nga të gjitha anët”. Megjithatë i kufizuar, me larminë e karakteristikave që zotëronte, ky terren mundësonte fshehjen e sigurt e të maskuar të forcave rezervë, me 6.000 luftëtarë, kryesisht kalorës dhe pjesa tjetër këmbësorë, që përbënin pak më tepër se një të tretën e gjithë forcave të Ushtrisë Shqiptare. Forcat e rezervës së fshehur dhe maskuar më së miri, do të luanin një rol tepër përcaktues në dhënien e goditjes vendimtare dhe fitoren e betejës nga Ushtria Shqiptare. Nga ana

tjetër ky terren lejonte një manovër të shpejtë e të njëkohshme nga krahët dhe shpina e kundërshtarit, nga lart-poshtë, duke e goditur dhe çuar në rrethimin gati të plotë të tij, pasi rruga e tërheqjes ishte e kufizuar dhe lehtësisht e kontrollueshme. Po ashtu, fushëbeteja e Torviollit mundësonte fushëpamje të plotë e, për rrjedhojë, edhe bashkëpunim po aq të mirë Rendimi luftarak në betejën e Torviollit 1444.

Torviolli u ideua nga Skënderbeu dhe oficerët e tij, si një betejë e rregullt fushore, sipas rregullave të artit ushtarak mesjetar. Historia shkencore e derisotme ka provuar se Ushtria Shqiptare e komanduar nga Skënderbeu ka organizuar dhe zhvilluar me sukses edhe shumë beteja fushore të rregullta, sipas parimeve dhe rregullave të artit ushtarak të Mesjetës. Një prej tyre ishte edhe beteja e parë, e zhvilluar midis ushtrisë Shqiptare dhe asaj osmane, të Torviollit.

Beteja e Torviollit, në pjesën e parë të saj, u gërshetua edhe me elementë të luftës partizane, si ndjellja, mashtrimi dhe manovra për ta lodhur, goditur, për ta dëmtuar e mashtruar, me synimin për ta sjellë kundërshtarin në vendin ku ishte parashikuar zhvillimi i betejës vendimtare.

Së fundmi, një ndër përfundimet më të vlefshme në pikëpamje ushtarake, që vërtetoi beteja e Torviollit, ishte fakti se edhe një ushtri e një vendi dhe populli të vogël si Shqipëria e asaj periudhe, nëse organizohet, stërvitet mirë, kur rreshtohet dhe komandohet mjeshtrësisht nga një komandant i madh dhe i veçantë, siç ishte Skënderbeu, mund të ndeshet dhe të fitojë edhe përballë ushtrive të fuqive të mëdha. Sidomos kur ajo lufton për të mbrojtur të drejtën dhe jetën e popullit të saj!

Një ndër arsytet thelbësore dhe bazë të fitores së Ushtrisë Shqiptare të dalë nga Kuvendi i Lezhës në betejën e parë kundër ushtrisë së superfuqisë osmane të asaj kohe, ishte bashkimi politik i princave shqiptarë dhe forcave ushtarake të tyre. Kjo ishte baza e fitores ushtarake. Nga ana tjetër, kjo fitore, dhe i të tjerave që pasuan në periudhën njëzetë e pesë vjeçare të udhëheqjes së heroit tonë kombëtar Gj. K. Skënderbeut, përbën njëherësh një mësim të çmuar dhe një ndër modelet më të mira për aktorët politikë të Shqipërisë së ditëve tona. Këto janë disa nga përfundimet dhe mësimet më të çmuara të betejës së Torviollit në 580 vjetorin e saj, por me një tingëllim dhe rëndësi gati-gati bashkëkohore!

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Komuniteti Kuantik Transatlantik (TQC) mbajti takimin e tij inaugurues virtual në Bruksel. Shtatorin e kaluar, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg bëri thirrje për zhvillimin e një rrjeti të dedikuar që do të rriste bashkëpunimin aleat dhe do të shfrytëzonte përfitimet e teknologjive kuantike për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen. Që nga ai takim, u miratua Strategjia Kuantike e Teknologjive të NATO-s dhe Stafi Ndërkombëtar i Aleancës bashkëpunoi me anëtarët e NATO-s për të krijuar Komunitetin.

Komuniteti Kuantik Transatlantik udhëhiqet nga aleatët, por pjesëmarrja është vullnetare. Më shumë se gjysma e aleatëve janë përfshirë tashmë, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Kanadanë, Francën, Italinë dhe Çekinë dhe nisma mbështetet nga Danimarka si kryetarja e parë kombëtare. Komuniteti do të mbledhë së bashku ekspertë kuantikë nga qeveritë kombëtare, industria, academia, organet financuese dhe institucionet kërkimore dhe do të ndihmojë në inkurajimin e inovacionit aleat, duke i mundësuar NATO-s të mbrojë avantazhin e saj teknologjik.

Roli i teknologjive kuantike në mjedisin e sigurisë po rritet dhe Komuniteti do të ndihmojë NATO-n të angazhohet me çështje kritike. Këto përfshijnë financimin dhe sfidat e teknologjisë, zhvillimin e talenteve dhe mundësitë e partneritetit. Plenari i parë vjetor i Komunitetit Kuantik Transatlantik pritet të mbahet këtë vjeshtë.

Përshtatje sa më të shpejtë në fushën kuantike

Në një vizitë në Kopenhagë, shtatorin e kaluar, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg bëri thirrje për zhvillimin e një komuniteti kuantik transatlantik, duke shfrytëzuar fuqinë e kësaj teknologjie kritike për sigurinë tonë. Në një deklaratë të përbashkët me kryeministren Mette Frederiksen, të dy liderët nënvizuan rëndësinë e bashkëpunimit më të ngushtë midis sektorëve publikë, privatë dhe akademikë, si dhe përshtetimin e inovacionit të përgjegjshëm. Duke folur së bashku me kryeministrin Frederiksen në Konferencën Kuantike të Kopenhagës të vitit 2023, Stoltenberg tha se: “NATO është përshtatur gjithmonë dhe ka miratuar teknologji të reja për të mbajtur popullin e saj të sigurt”. Ai shtoi se: “me përhapjen e shpejtë të teknologjive përçarëse, ne duhet të përshtatemi më tej dhe më shpejt se kurrë më parë, duke përfshirë edhe në fushën kuantike. Ne duhet të sigurohemi që këto teknologji të funksionojnë për ne dhe jo kundër nesh. Ai vlerësoi më tej Danimarkën për të qenë “një forcë shtytëse pas agjendës së inovacionit të NATO-s dhe një lider në fushën e teknologjive kuantike në Evropë.

Sekretari i Përgjithshëm konfirmoi atëherë se: “NATO do të kishte të zhvilluar një strategji kuantike deri në fund të vitit, për të siguruar që Aleanca të jetë gati kuantike dhe në gjendje të integrojë teknologjitë e duhura në aftësitë tona dhe të mbrojë kundër përdorimit kundërshtar”. Dhe po gjatë asaj dite, Sekretari i Përgjithshëm hapi faqen e re të përshtetjesit të NATO-s “Deep Tech Lab – Quantum” së bashku me ministrin danez të Mbrojtjes, dhe ministra të tjerë danezë. Laboratori ndihmon start-up-et që aleatët të komercializojnë zgjidhjet e aktivizuara kuantike, si pjesë e Përshtetjesit të ri të Inovacionit të Mbrojtjes të NATO-s për Atlantikun e Veriut (DIANA). DIANA përbëhet nga një rrjet qendrash testimi dhe vendesh përshtetjesish nëpër vendet e NATO-s, ku inovatorët zhvillojnë teknologji të reja për të zgjidhur sfidat urgjente të sigurisë. Laboratori i teknologjisë së thelluar, Quantum në Kopenhagë është një nga pesë vendet pilot të përshtetjesve të lançuar në vitin 2023.

Vizioni Strategjik, një Aleancë e gatshme për Kuantikë

Përparimet e fundit në teknologjitë kuantike po na afrojnë me një ndryshim të thellë për shkencën dhe teknologjinë, një ndryshim që do të ketë implikime të gjera për ekonominë, sigurinë dhe mbrojtjen tonë. Këto teknologji mund të revolucionarizojnë ndjeshmërinë; imazherinë; pozicionimin e saktë, navigimin dhe kohën; komunikimet; informatikën; modelimin; simulimin; dhe shkencën e informacionit. Teknologjitë kuantike kanë implikime potencialisht revolucionare dhe shkatërruese, të cilat mund të degradojnë aftësinë e Aleancës për të penguar dhe mbrojtur. Prandaj, teknologjitë kuantike janë një element i konkurrencës strategjike.

Teknologjitë kuantike kanë potencialin për të ofruar aftësi në informatikë, komunikim dhe ndërgjegjësim për situatën që janë të pakrahueshme me teknologjinë aktualisht të disponueshme për Aleancën dhe që mund të përbëjnë një avantazh të rëndësishëm strategjik. Megjithatë, teknologjitë kuantike mund të mundësojnë në mënyrë të barabartë konkurrentët tanë strategjikë dhe kundërshtarët e mundshëm.

Për t'u bërë një Aleancë e gatshme për kuantikë, NATO dhe aleatët duan të nxisin zhvillimin e një ekosistemi kuantik të sigurt, elastik dhe konkurrues që është në gjendje t'i përgjigjet ritmit të shpejtë të konkurrencës teknologjike në industrinë kuantike. Kjo kërkon koherencë në investime, bashkëpunim midis aleatëve në mundësitë e zhvillimit të teknologjisë, zhvillimin dhe mbrojtjen e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe rritjen e ndërgjegjësimit për situatën, si dhe shkëmbimin e informacionit. Ajo gjithashtu kërkon zhvillimin dhe vendosjen e teknologjive kritike aftësuese që kërkojnë teknologjitë kuantike. “Është po aq e rëndësishme të parandalojmë dhe mbrojmë sistemet dhe rrjetet tona kundër sulmeve kuantike dhe sulmeve të tjera”.

Për të arritur ambicien strategjike për t'u bërë një Aleancë e

Teknologjia të jetë për ne dhe jo kundër nesh

Danimarka kryeson takimin inaugurues të Komunitetit Kuantik Transatlantik të NATO-s



gatshme për kuantikë, NATO dhe aleatët shfrytëzojnë teknologjitë kuantike në mbështetje të detyrave kryesore të Aleancës, duke ecur drejt rezultateve të dëshiruara. “Aleatët dhe NATO kanë identifikuar aplikimet kuantike ushtarake dhe me përdorim të dyfishtë më premtues, eksperimentet dhe integrimin e teknologjive kuantike që plotësojnë kërkesat e planifikimit të mbrojtjes dhe zhvillimit të aftësive; NATO ka zhvilluar, miratuar dhe zbatuar korniza, politika dhe standarde si për softuerin ashtu edhe për harduerin për të rritur ndërveprimin; Aleatët kanë bashkëpunuar në zhvillimin e teknologjive kuantike me synimin për të ruajtur avantazhin teknologjik të NATO-s dhe aftësitë e aleatëve në terren; NATO ka identifikuar, kuptuar dhe ka kapitalizuar mbi përparimet në zhvillim të teknologjive kuantike, duke përfshirë teknologjitë mundësuese dhe në konvergencë me EDT të tjera; NATO ka një Komunitet Kuantik Transatlantik për t'u angazhuar në mënyrë strategjike me qeverinë, industrinë dhe akademinë nga të gjithë ekosistemet tona të inovacionit; NATO ka kaluar sistemet e saj kriptografike në kriptografi të sigurt kuantike; Strategjitë përkatëse kuantike, politikat dhe planet e veprimit përditësohen dhe zbatohen në mënyrë dinamike; dhe aleatët janë bërë të vetëdijshëm dhe kanë vepruar për të parandaluar, mbi baza vullnetare, investimet kundërshtarë dhe ndërhyrjet në ekosistemet tona kuantike, të cilat mund të përfshijnë, në bazë kombëtare, ekzaminimin e zinxhirëve përkatës të furnizimit”.

Më tej, NATO thotë se: “do të sigurojë forumin kryesor transatlantik për teknologjitë kuantike në mbrojtje dhe siguri, duke ndihmuar në ndërtimin e vazhdueshëm të të kuptuarit tonë të përbashkët dhe duke shfrytëzuar potencialin e teknologjive kuantike, duke mbrojtur kundër përdorimit të saj kundërshtar”.

Nxjtja e një aleance të gatshme për kuantikë dhe inovacioni i përgjegjshëm

Aleatët dhe NATO po përshtetjojnë urgjentisht zhvillimin e teknologjive kuantike që mund të rrisin aftësitë tona, si dhe të parandalojnë formimin e boshllëqeve të reja të aftësive në një botë ku konkurrentët e tjerë adoptojnë vetë teknologjitë kuantike. Por duke pasur parasysh natyrën e përdorimit të dyfishtë të teknologjive kuantike, ky avantazh mund të arrihet vetëm nëse bëhet në bashkëpunim të ngushtë me ekosistemet kuantike aleate. Aleatët dhe NATO duhet të miratojnë një qasje ‘të mësosh duke bërë’ për të integruar konsideratat e teknologjive kuantike në zbatimin e koncepteve tona operationale, ciklet e planifikimit të mbrojtjes, ciklet e zhvillimit të aftësive dhe përpjekjet e standardizimit, referon NATO.

Ndërsa DIANA dhe Fondi i Inovacionit të NATO-s (NIF) bëhen plotësisht funksionale, aktivitetet e tyre të teknologjisë së thelluar “do të informojnë gjithashtu qasjen strategjike të NATO-s ndaj teknologjive kuantike dhe do të përforcojnë angazhimin e NATO-s me ekosistemin kuantik aleat”.

Konvergjenca midis teknologjive kuantike dhe EDT-ve të tjera sjell implikime të rëndësishme të mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe aplikime dhe aftësi të mundshme ushtarake. Shembujt përfshijnë përdorimin e sensorëve kuantikë për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave të bazuara në hapësirë dhe për të mundësuar pozicionimin, navigimin dhe aftësitë e kohës pa pasur nevojë të mbështeteni në Sistemet Globale Satelitore të Navigimit.

NATO pranon se një nga burimet më kritike në ndjekjen e avantazhit kuantik është talenti, i cili do të jetë një përcaktues kritik i trajktores së ardhshme të Aleancës në këtë fushë. Ndërsa teknologjitë kuantike fitojnë tërheqje, po kështu do të rritet kërkesa për ekspertë me diploma të avancuara në këtë fushë, thotë NATO.

Ndërsa teknologjitë kuantike kanë implikime etike më pak të dukshme në lidhje me EDT-të e tjera si AI-ja, autonomia ose bioteknologjia dhe përmirësimi njerëzor, aleatët dhe NATO janë



megjithatë të përkushtuar për të krijuar një qasje të përgjegjshme ndaj inovacionit të teknologjive kuantike. Kjo do të mbulojë tre fusha kryesore si lidhjet me privatësinë e të dhënave, parashikimin e zhvillimit të normave ndërkombëtare dhe konsideratat e qëndrueshmërisë.

Komitetet e NATO-s “do të shërbejnë gjithashtu si platforma për aleatët për të shkëmbyer dhe bashkuar pikëpamjet mbi normat kuantike në rritje në sigurinë ndërkombëtare, ndërsa ato zhvillohen. Aleatët do të shkëmbejnë pikëpamje në NATO, në përputhje me këtë Strategji dhe në dritën e forumeve të tjera ndërkombëtare”.

Për të informuar një trajtim gjithëpërfshirës të rreziqeve dhe mundësive të fushës së teknologjive kuantike, Bordi i Rishikimit të të Dhënave dhe AI-ja (DARB) ofron këshillat e tij mbi implikimet e zhvillimeve në të dhëna dhe AI për teknologjitë kuantike, informon NATO.

Komuniteti Kuantik Transatlantik dhe mbrojtja e Aleancës nga Kërcënimi Kuantik

Një Aleancë e gatshme për kuantikë kërkon, para së gjithash, një bashkëpunim më të ngushtë midis aleatëve dhe një ekosistem kuantik elastik që shtrihet përtej disponueshmërisë së financimit të duhur. Rritja e suksesshme dhe adoptimi i teknologjive kuantike varet gjithashtu nga disponueshmëria e teknologjive të mundshme dhe lidhjet efektive midis zbulimeve të reja kërkimore dhe metodave inxhinierike. Teknologjitë kuantike janë veçanërisht të varura nga teknologjitë aftësuese. Për shembull, kompjuterët kuantikë kërkojnë mjete të sakta metrologjike, aftësi të sigurt prodhuese të prodhimit të specializuar dhe kriogjenikë.

Përdoruesit përfundimtarë dhe drejtuesit e industrisë së mbrojtjes luajnë një rol vendimtar në përkthimin e rasteve të përdorimit të teknologjive kuantike premtuese në aftësi. NATO është pozicionuar në mënyrë unike për të ndërmjetësuar mundësitë e bëra të mundshme nga EDT me industrinë, qeveritë dhe përdoruesit përfundimtarë. Ritmi i shpejtë i zhvillimit të teknologjive kuantike kërkon një qasje koherente ndaj këtij lloji të koordinimit dhe rreshtimit ndërmjet aleatëve, i cili do të sigurohet nga krijimi i një Komuniteti Kuantik Transatlantik.

Nga ana tjetër teknologjitë kuantike kanë një ndikim të dyfishtë në sigurinë dhe mbrojtjen kibernetike, duke përfutur si palën mbrojtëse ashtu edhe atë sulmuese. Nëse miratohen plotësisht, teknologjitë kuantike funksionale do të lejojnë aktorët privatë dhe publikë në Aleancë të mbrojnë më mirë të dhënat dhe komunikimet e tyre në një mënyrë të shpejtë dhe të besueshme. Një Aleancë e gatshme për kuantikë do të jetë më e aftë të zbulojë dhe bllokojë inkursionet e mundshme në hapësirën kibernetike.

Një kompjuter kuantik funksional do të kishte gjithashtu aftësinë për të thyer protokollet aktuale kriptografike. Sot, kriptografia post-kuantike është një qasje e rëndësishme për të siguruar komunikime kundër sulmeve të aktivizuara nga kuantika. Në të ardhmen, përmirësimet të mëtejshme mund të lejojnë shpërndarjen kuantike të çelësave të kontributojë gjithashtu në komunikime të sigurt. Nëpërmjet komiteteve dhe organeve të NATO-s, “aleatët mbështesin njëri-tjetrin dhe Ndërmarrjen e NATO-s, në zhvillimin dhe zbatimin e kriptografisë post-kuantike dhe shpërndarjes së çelësave kuantikë për të rritur qëndrueshmërinë kuantike të rrjeteve tona”. NATO thotë se do të vazhdojë të mbështesë kërkimin për kalimin në komunikime të sigurt kuantike në domenet ajrore, hapësinore, kibernetike, tokësore dhe detare. Konkurrentët strategjikë dhe kundërshtarët e mundshëm mund të përdorin gjithashtu mundësi dezinformimi brenda shoqërive aleate duke krijuar mosbesim publik ndaj përdorimit ushtarak të teknologjive kuantike. Aleatët përpiqen të parandalojnë dhe kundërshtojnë çdo përpjekje të tillë nëpërmjet përdorimit të komunikimeve strategjike dhe NATO i mbështet aleatët sipas nevojës.

Mbeturinat hapësinore po bien në Tokë

NASA gjurmon mbeturinat hapësinore që rrotullohen rreth Tokës. Në fillim të këtij viti, qetësia e një lagjeje të Floridës u shkatërrua kur një pjesë e mbeturinave nga Stacioni Ndërkombëtar i Hapësirës u përplas në një shtëpi. Kjo u pasua në maj nga një pjesë 90 kilogramësh e një anijeje “SpaceX” “Dragon” që u përplas në një vendpushim kampingu në Karolinën e Veriut, Lind pyetja: A po bëjnë agjencitë hapësinore mjaftueshëm për të na mbrojtur nga rënia e mbeturinave hapësinore?

Ndërsa agjencitë qeveritare si NASA dhe kompani private si “SpaceX” dhe “Blue Origin” garojnë për të dërguar gjithnjë e më shumë teknologji në orbitë, një raport i ri nga “Ars Technica” paralajmëron se duhet bërë më shumë për të menaxhuar mbeturinat e hapësirës.

Hapësira mbi planetin tonë aktualisht është e mbushur me gjithçka, nga mbetjet e programit “Apollo” deri te mbetjet nga ISS dhe madje edhe satelitët e zhdukur. Për të hequr këto mbeturina, shkencëtarët zakonisht shpenzojnë vite, duke punuar për mënyra të sigurta për të sjellë gjëra të tilla si satelitët jashtë shërbimit përsëri në Tokë, që përfshin detyrimin e tyre të digjen në atmosferën tonë ose përplasjen përsëri në oqean. Megjithatë, kjo nuk shkon gjithmonë sipas planit.

Në fakt, këtë vit është vënë re një rritje e çuditshme në numrin e pjesëve të mbeturinave hapësinore që zbarkojnë në tokën amerikane. Rritja vjen pasi një fluks satelitësh të rinj po lëshohen si pjesë e sistemit “Skylink” dhe kompanitë private fillojnë të dërgojnë gjithnjë e më shumë njerëz në kozmos.

E gjithë kjo do të thotë se siguria e njerëzve të pafajshëm në Terra Firma është në rrezik, pasi rënia e mbeturinave hapësinore bëhet më pak e parashikueshme. Sipas “Ars Technica”, ekspertët kanë paralajmëruar se tani ka shumë variabla në lojë, kur bëhet fjalë për parashikimin se si mbeturinat hapësinore do të bien përsëri në Tokë.

Si rezultat, rreziqet e përplasjes së mbeturinave hapësinore në tokë po rriten. Në rastin e një pjesëze të një anijeje “Dragon” që u rrëzua në tokën e SHBA-së, gjithçka, nga thurja e materialeve të përdorura deri te mënyra se si ra në atmosferë, ndikoi në mënyrën se si anija i mbijetoi udhëtimit, siç shpjegon “Ars Technica”:

Orientimi i një anije kozmike ndërsa bie në atmosferë mund të jetë gjithashtu faktor i mbijetesës, tha Greg Henning, menaxher i seksionit të mbeturinave dhe asgjësimit brenda departamentit të ndërgjegjësimit për situatën hapësinore të “Aerospace”.

Ndërsa testet mund të bëhen përpara se një anije kozmike e zhdukur të fillojë zbritjen e saj, këto llogaritje nuk ofrojnë gjithmonë pasqyrën më të mirë. Në fakt, inxhinierët e NASA-s dhe “SpaceX” projektuan se pjesët e “Dragoit” që ranë në Tokë do të digjen në procesin intensiv të rihyrjes, pa asnjë pjesë të tij që nuk pritet të mbijetojë.

Kjo nuk ndodhi, dhe mbetjet prekën tokën amerikane. Tani, NASA dhe “SpaceX” do të analizojnë mbetjet për t’u dhënë atyre një ide më të mirë se si sillen komponentët dhe materialet kur bien të lirë nga hapësira. Siç shton “Ars Technica”: “Gjatë projektimit të tij fillestar, trangu i anijes kozmike ‘Dragon’ u vlerësua për ndarjen e rihyrjes dhe u parashikua të digjej plotësisht”, - tha NASA në një deklaratë. “Informacioni nga rikuperimi i mbeturinave ofron një mundësi për ekipet për të përmirësuar modelimin e mbeturinave. NASA dhe ‘SpaceX’ do të vazhdojnë të eksplorojnë zgjidhje shtesë siç mësojmë nga mbeturinat e zbuluara”.

Deri më tani, takimet e afërta që kemi pasur me mbeturinat hapësinore në rënie nuk kanë dëmtuar askënd në Amerikë. Dhe ndërsa Agjencia Evropiane e Hapësirës pohon se rreziku vjetor që një individ të lëndohet nga rënia e mbeturinave nga hapësira është më pak se 1 në 100 miliardë, ky rrezik mund të rritet.

Tani ka më shumë se 120 milionë copë mbeturinash që lundrojnë në hapësirë tani, dhe ndërsa shumë, me siguri nuk do të arrijnë kurrë tokë, rreziqet që ato paraqesin do të vazhdojnë të rriten me rritjen e numrit.

Cilat janë mbeturinat e hapësirës dhe si ndikojnë në mjedis?

Mbeturinat hapësinore klasifikohen nga NASA nëse janë me origjinë natyrore apo artificiale, me këtë të fundit të përcaktuar si “çdo objekt i krijuar nga njeriu në orbitë rreth Tokës që nuk shërben më një funksion të dobishëm”. Por si ndikojnë mbeturinat e hapësirës në mjedis dhe tek ne? Akumulimi i mbeturinave hapësinore përbën një kërcënim veçanërisht katastrofik për të ardhmen e njerëzimit në eksplorimin e hapësirës, për shkak të rritjes së rrezikut të përplasjes dhe dëmtimit të satelitëve funksionalë. Mund të ketë gjithashtu efekte të dëmshme në mjedisin e Tokës.

Çfarë janë mbeturinat hapësinore?

Mbeturinat hapësinore artificiale ose orbitale përbëhen nga objekte që variojnë nga pikat e bojës nga stacionet hapësinore funksionale, deri tek ato të mëdha sa dekada të vjetra, anije kozmike jofunksionale. Që nga gushti 2021, Agjencia Evropiane e Hapësirës (ESA) raporton se rreth 29,210 copë mbeturinash gjurmohen rregullisht nga Rrjetet e Mbikëqyrjes Hapësinore. Megjithatë, statistikisht, shifrat ka të ngjarë të jenë shumë më të larta. Numri i objekteve artificiale në orbitë rreth Tokës që janë



më të mëdha se 10 cm në gjatësi ka të ngjarë të jetë afërsisht 34,000, me rreth 900,000 objekte midis 1 cm dhe 10 cm. Për ato objekte midis 1 mm dhe 1 cm, numri është rreth 128 milionë. Rrjedhimisht, numri i madh i këtyre objekteve aktualisht në orbitë dhe potenciali i tyre për t’u përplasur me objekte të tjera me shpejtësi deri në 5 milje në sekondë, do të thotë se rreziku për të shkaktuar dëme serioze në një anije funksionale të hapësirës është i konsiderueshëm. Në vitin 2006, dritarja e fortifikuar me silic të shkrirë dhe me xham boro silikat të Stacionit Ndërkombëtar të Hapësirës (ISS) pësoi një çip 7 mm për shkak të një goditjeje nga një pjesë e mbeturinave hapësinore jo më të madhe se të mijtët e milimetrit. Është e lehtë të shihet kërcënimi i paraqitur nga objekte shumë më të mëdha.

Një përplasje e vetme mund të gjenerojë mijëra grimca të mbeturinave hapësinore. Në vitin 2009, sateliti rus joaktiv “Cosmos 2251” u përplas me satelitin aktiv amerikan të komunikimit “Iridium 33” afërsisht 804 km mbi Siberi, duke rezultuar në rreth 2000 copë mbeturinash të paktën 10 cm në diametër dhe mijëra copa të tjera më të vogla, që hynë në atmosferën e Tokës. Është vlerësuar se mbi 50% e mbeturinave nga “Iridium 33” do të qëndrojnë në orbitë për të paktën një shekull, dhe ajo e “Cosmos 2251” për të paktën 20 deri në 30 vjet.

Efektet e ndotjes së hapësirës dhe ndikimi i mbeturinave hapësinore

Shumica e mbeturinave hapësinore janë të vendosura në atë që njihet si orbita e ulët e Tokës - zona brenda përafërsisht 2011 km nga sipërfaqja e planetit dhe në të cilën veprojnë shumë satelitë, si ISS dhe Sistemi i Flotës së Vëzhgimit të Tokës të NASA-s. Efektet e mbeturinave hapësinore mund të jenë të rëndësishme; lejimi i grumbullimit të mbeturinave hapësinore dhe tani e tutje rritja e rrezikut të përplasjeve të mëtejshme të ngjashme me atë të “Iridium 33” dhe “Cosmos 2251”, përbën një rrezik të madh për mundësinë e eksplorimit të hapësirës në të ardhmen.

Më shumë se 4700 nisjet që janë kryer në të gjithë globin që nga “Sputnik 1” në vitin 1957 kanë rezultuar në një prirje të madhe rritëse në masën materiale në orbitën e Tokës, e cila ka tejkaluar 700 tonë metrikë dhe nuk tregon shenja të zbutjes. Sipas simulimeve kompjuterike që fokusohen në 200 vitet e ardhshme, gjatë kësaj kohe mbeturinat më të mëdha se rreth 20 cm në gjerësi do të shumohen 1.5 herë. Mbeturinat midis 10 dhe 20 cm janë caktuar të shumëzohen 3.2 herë, dhe mbeturinat më të vogla se 10 cm do të rriten me një faktor prej 13 deri në 20. Rreziku që kjo paraqet për satelitët si ISS, të cilët që nga viti 2016 duhet të kryejnë 25 manovrat e shmangies së përplasjes së mbeturinave që nga viti 1999, janë të konsiderueshme.

Problemi nuk kufizohet në rrezikun që paraqet eksplorimi i hapësirës. Një pjesë e mbeturinave hapësinore në orbitën e ulët të Tokës do të humbasë gradualisht lartësinë dhe do të digjet në atmosferën e Tokës; mbeturinat më të mëdha, megjithatë, herë pas here mund të depërtojnë në Tokë dhe të kenë efekte të dëmshme në mjedis. Për shembull, mbeturinat nga raketat ruse “Proton”, të lëshuara nga kozmodromi “Baikonur” në

Kazakistan, mbushin rajonin Altai të Siberisë lindore. Kjo përfshin mbeturinat nga rezervuarët e vjetër të karburantit që përmbajnë mbetje karburanti shumë toksike, dimetilhidrazinë josimetrike (UDMH), një kancerogjen që është i dëmshëm për bimët dhe kafshët. Ndërsa bëhen përpjekje për të frenuar pasojat nga lëshimet brenda një zone të caktuar, është jashtëzakonisht e vështirë të arrihet plotësisht.

Anatoli Kuzin, zëvendës drejtor i Qendrës Hapësinore Shtetërore të Kërkimit dhe Prodhimit Khrunichev, e cila prodhon raketa “Proton”, pohon se testimi i plotë nuk tregon asnjë lidhje midis sëmundjeve të raportuara në zonat e prekura dhe lëshimeve të raketave. Dëshmitë nga vendasit, megjithatë, i referohen një numri joproporcional të rasteve të kancerit në zonë që shumë besojnë se lidhet me UDMH në mbeturinat e rezervuarit të karburantit; në vitin 2007, 27 persona u shtruan në spital në distriktin Ust-Kansky të Altait me komplikime të lidhura me kancerin, shumë prej tyre duke përmendur karburantin e raketës si shkakun e dyshuar.

Përpjekjet për të trajtuar problemin filluan në vitet 1990, me politikën dhe udhëzimet e NASA-s për zbutjen e mbeturinave orbitale. Politika Kombëtare e Hapësirës e SHBA-së e 2006 dhe 2010 thekson domosdoshmërinë për të zbatuar Praktikat Standarde të Zbutjes së Mbetjeve Orbitale të Qeverisë së SHBA-së, të cilat i japin përparësi kontrollit të çlirimit të mbeturinave, përzgjedhjes së profilit të sigurt të fluturimit dhe konfigurimit operacional, dhe asgjësimit të sigurt të aparatit hapësinor pas një misioni. Viti 2002 pa konsensusin e parë standard të njohur ndërkombëtarisht mbi udhëzimet për zbutjen e mbeturinave orbitale, por i vendosur nga Komiteti Ndër-Agjenci i Koordinimit të Mbetjeve Hapësinore.

Megjithatë, kreu i zyrës së ESA-s për mbetjet hapësinore në Gjermani, Holger Krag, vlerëson se vetëm gjysma e të gjitha emetimeve në hapësirë i përmbahen këtyre udhëzimeve. “Futja e mega-konstelacioneve, grupimet masive të satelitëve artificialë, në orbitën e ulët të Tokës, - paralajmëron Krag, - do të sjellë nevojën për të hequr satelitët e dështuar nga hapësira, për të cilat shumica e kompanive nuk do të duan të shpenzojnë para”.

Në maj 2020, ekonomistët në Universitetin e Kolorados Boulder propozuan t’i bashkëngjiten një tarife vjetore, që rritet 14% në vit, për çdo satelit të vendosur në orbitë me shpresën se tarifa mund të dekurajojë akumulimin e panevojshëm të mbeturinave hapësinore. Masa të tjera të propozuara ndër vite kanë përfshirë heqjen e pjesëve të mëdha të mbeturinave me instrumente si fuzhnjë dhe lazer, zhvillimin e satelitëve vetë-heqës dhe veshjen e satelitëve me shkumë polimerike, për t’i lejuar ata të zbrisin në atmosferën e Tokës dhe të digjen. lart. Megjithatë, ende nuk ka një zgjidhje të njohur botërisht për problemin. Më shumë kompani të fluturimeve hapësinore duhet t’u përmbahen udhëzimeve të përcaktuara nga Komiteti Ndër-Agjenci i Koordinimit të Mbetjeve Hapësinore dhe është jetike që lëvizja për të reduktuar akumulimin e ardhshëm të mbeturinave hapësinore të bëhet një përpjekje më kohezive dhe e fuqishme.

Lufta kibernetike, një kërcënim real

Lufta kibernetike ka ndryshuar betejat bashkëkohore, duke ndikuar në sigurinë kombëtare dhe infrastrukturën thelbësore në mbarë botën. Shtetet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare përdorin sisteme kompjuterike, rrjete dhe teknologji për të sulmuar dhe prishur funksionet vendimtare të kombeve të tjera, duke synuar përgjithësisht sistemet kompjuterike qeveritare, rrjetet financiare dhe infrastrukturën civile. Lufta kibernetike mund të dëmtojë infrastrukturën kritike, të shpërndajë dezinformata dhe të dëmtojë ekonominë në një shkallë të barabartë me një sulm fizik.

Kërcënimet mund të përfshijnë jo vetëm sulme malware, por edhe luftën hibride dhe objektivat vitale të infrastrukturës industriale. Sulme të tilla, shpesh të perceptuara si një realitet i largët, janë bërë një shqetësim kryesor për sigurinë e vendeve, pasi ato prekin gjithçka, nga rrjetet elektrike e deri te informacionet e ndjeshme brenda agjencive qeveritare.

Rrjedhimisht, siguria efektive kibernetike kombinon parandalimin me kundërmasat për të mbrojtur sistemet kompjuterike.

Një përkufizim i luftës kibernetike

Epoka dixhitale e ka bërë më të rëndësishme luftën kibernetike – vendosjen strategjike të sulmeve kibernetike nga një shtet-komb ose organizatë ndërkombëtare për të synuar sigurinë kombëtare, infrastrukturën civile ose infrastrukturën qytetare të një vendi tjetër. Sulmet kibernetike dëmtojnë sistemet thelbësore, përhapin dezinformata dhe shqetësojnë ekonominë dhe shoqërinë.

Hakerimi, malware dhe mohimi i shërbimit të shpërndarë (DDoS) janë të gjithë shembuj të sulmeve të luftës kibernetike. Sullmuesit kibernetikë zakonisht synojnë infrastrukturën të ndryshme thelbësore, duke përfshirë kompanitë e karburantit, kompanitë e shërbimeve, institucionet financiare dhe qeveritë. Qëllimi i të njëjtëve sullmues është të prishin sistemet kritike, të vjedhin të dhëna të ndjeshme ose të shkatërrojnë vetë strukturat që mbështesin shumicën e sistemeve ekonomike moderne.

Skenarët e luftës kibernetike mund të përfshijnë hackerimin e rrjeteve virtuale për të fituar akses të paautorizuar dhe për të marrë të dhëna ose viruse. Viruset mund të dëmtojnë, shkatërrojnë ose marrin kontrollin e sistemeve kompjuterike, duke rrezikuar infrastrukturën qeveritare, private dhe publike. Sulmet e shpërndara të mohimit të shërbimit, të cilat mbingarkojnë sistemet me kërkesa të rreme, mund të pengojnë operacionet ushtarake dhe shërbime të tjera jetike.

Sulmet ransomware përdoren gjithashtu në luftën kibernetike. Një sulm ransomware mbyll përdoruesit legjitimë jashtë sistemeve kompjuterike derisa ata të paguajnë një shpërblim. Koreja e Veriut dhe Irani kanë përdorur një sulm ransomware për të shkaktuar konflikt në vende të tjera, për të ndërprerë shërbimet jetike moderne dhe për të përhapur propagandë.

Spiunazhi kibernetik është një tjetër taktikë e luftës kibernetike për të vjedhur informacione të ndjeshme nga rrjetet kompjuterike të një vendi të synuar. Inteligjenca mund të synojë sistemet ushtarake, menaxhimin e personelit dhe sekretet e korporatave.

Një konflikt kibernetik mund të dëmtojë vendin e synuar, si dhe rrjetet globale si tregjet financiare dhe të aksioneve dhe sistemet e pagesave. Për të mbrojtur kompjuterët dhe objektet kritike, qendrat kombëtare të komandës kibernetike dhe iniciativat ndërkombëtare të sigurisë kibernetike duhet të përshtaten me kompleksitetin në rritje të armëve kibernetike dhe strategjive të sulmit. Të kuptuarit se çfarë është siguria kibernetike dhe roli i saj në përpjekjet e mbrojtjes është parësor në ndërtimin e mbrojtjeve të fuqishme.

Shembuj të rëndësishëm të luftës kibernetike

Disa ngjarje tregojnë se si sulmet kibernetike ndikojnë në qeveritë, ekonominë dhe kulturat. Operacioni i famshëm i luftës kibernetike, Stuxnet, synoi një program bërthamor iranian, sipas CSO Online.

Ky virus i avancuar u mundësoi sullmuesve të hakinë vendet e pasurimit të uraniumit në Iran. Shumë e interpretuan sulmin si një akt të luftës kibernetike që vonoi objektivat bërthamore të Iranit dhe ngriti shqetësime kritike për sigurinë kibernetike të infrastrukturës industriale.

Një shembull tjetër i luftës kibernetike vjen nga “Lazarus Group” i Koresë së Veriut, një organizatë e sofistikuar hakerash e njohur për përdorimin e aftësive të saj teknike për të vjedhur kriptomonedha me vlerë miliona dollarë. Sulmet kibernetike të platformës krypto bëjnë të mundur vjedhjen e parave, çaktivizimin e sistemeve kritike dhe madje prishjen e ekonomive. Sulmet kibernetike të ekzekutuara nga “Lazarus Group” gjatë mbi 10 viteve të fundit kanë shkaktuar humbje të konsiderueshme financiare dhe kanë ekspozuar se sa të cenueshme janë teknologjitë e reja financiare ndaj luftës kibernetike.

Megjithatë, sulmet nuk janë të kufizuara në sferën dixhitale, siç dëshmohet nga Operacioni i Izraelit “Orchard”. Operacioni “Orchard”, i cili synonte një kompleks të dyshuar bërthamor sirian, tregoi se si sulmet kibernetike mund të integrohen me veprimet konvencionale. Izraeli çaktivizoi mbrojtjen ajrore siriane, duke i treguar botës se si llojet e luftës kibernetike mund të përputhen me veprimet ushtarake.

Secili prej këtyre sulmeve nxjerr në pah nevojën për siguri dhe monitorim të fuqishëm kibernetik në zhvillimin e strategjive të luftës kibernetike. Ato tregojnë gjithashtu se si lufta kibernetike ndikon në marrëdhëniet ndërkombëtare pasi kombet përfshijnë strategji kibernetike në operacionet e tyre ushtarake.

Historikisht, lufta kibernetike ka pasur pasoja të gjera. Sulmet kanë dëmtuar sistemet jetike, duke përfshirë ekonominë dhe sigurinë e shtetit. Aktorët e kërcënimit operacionel dhe strategjik, dikur të lidhur nga vendndodhja gjeografike, tani mundojnë vendet dhe organizatat në një shkallë globale. Operacionet e luftës kibernetike



ndryshuan sigurinë kibernetike në mbarë botën, duke ripërcaktuar normat e konfliktit dhe strategjitë e mbrojtjes së kombit/shtetit.

Aktorët Joshtetërorë

Aktorët joshtetërorë sfidojnë gjithnjë e më shumë luftën kibernetike dhe sigurinë e vendit. Ky grup përfshin grupe të ndryshme të dhunshme terroriste, organizata proxy, aktivistë, hakerë dhe kriminelë të tjerë. Çdo lloj aktori mund të veprojë ndryshe, nga ekzekutimi i sulmeve të rëndësishme virale deri te kryerja e spiunazhit kompleks kibernetik.

Infrastruktura kritike, rrjetet qeveritare dhe sistemet industriale janë të gjitha objektiva të shpeshta për këta sullmues. Sulmet mund të përdorin teknika të dizajnuara për të vjedhur të dhëna, për të hyrë në kompjuterë thelbësorë dhe për të ndërprerë aktivitetet civile dhe ushtarake. Lufta kibernetike nga aktorët joshtetërorë si organizatat terroriste është e ndërlikuar dhe në ndryshim të vazhdueshëm, duke kërkuar përgjigje të avancuara dhe të sofistikuara për të mbrojtur interesat e shtetit-komb dhe shërbimet kritike.

Organizatat terroriste dhe ekstremiste të dhunshme

Terroristët dhe organizatat e dhunshme ekstremiste (VEO) po përdorin luftën kibernetike për të ngjallur frikë tek qytetarët e një kombi, për të përgjuar komunikimet dhe për të sulmuar rrjetet qeveritare dhe civile. Këto organizata mund të vjedhin të dhëna, të hakinë sisteme dhe madje të mbyllin potencialisht rrjetet e energjisë dhe tregjet e aksioneve nëpërmjet sulmeve kibernetike.

Lufta e integruar u mundëson këtyre grupeve të destabilizojnë - ose të sjellin dëm të konsiderueshëm - ekonominë dhe qeveritë pa përdorur forcë fizike. Këto kërcënime të mundshme dëshmojnë se sa të fuqishëm mund të jenë sulmet kibernetike. Qeveritë nuk kanë zgjidhje tjetër veçse t'i japin përparësi mbrojtjeve kibernetike në mënyrë që të shmangin numrin gjithnjë në rritje të kërcënimeve globale.

Hakerë, aktivistë dhe haktivistë

Hakerët, qofshin ata që veprojnë si grupe apo individë, shpesh kanë objektiva politike dhe/ose financiare. Hakerët mund të hyjnë në sistemet qeveritare për të vjedhur të dhëna ose për të ndërprerë operacionet. Ata mund të mbledhin fondet në mënyrë elektronike nga bizneset për përfitimin e tyre personal.

Aktivistët që abuzojnë me hapësirën kibernetike për të përhapur ide dhe për të dëmtuar grupet konkurruese quhen “haktivistë”. Sulmet e tyre kibernetike mund të përfshijnë fushata dezinformuese dhe sulme DDoS në faqet e internetit jetike. Aktivitete të tilla prishin sistemet kritike bashkëkohore, duke kërcënuar sigurinë afatshkurtër dhe afatgjatë. Në fund të fundit, lufta kibernetike e ka transformuar internetin në një fushë betejë, ku loja e pushtetit, spiunazhi dhe manipulimi financiar bashkohen.

Kriminelët kibernetikë dhe krimi i organizuar

Kriminelët kibernetikë theksojnë nevojën për siguri kibernetike gjithëpërfshirëse dhe adaptive. Këta aktorë të poshtër paraqesin një gamë të gjerë kërcënimesh kibernetike. Qeveritë dhe korporatat duhet të rivlerësojnë vazhdimisht sistemet dhe protokollet e tyre të sigurisë pasi kriminelët kibernetikë vazhdojnë të sfidojnë normat.

Nëpërmjet qasjeve dhe strategjive të tyre të ndryshme, kriminelët kibernetikë demonstrojnë kompleksitetin dhe potencialin në rritje të sulmeve dixhitale. Ato kërkojnë siguri të fortë në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Fatmirësisht, ekzistojnë agjenci si Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Komanda Kibernetike e SHBA-ve. Komanda Kibernetike merr masa aktive për të mbrojtur sistemet dhe infrastrukturën kompjuterike kundër një sulmi të vazhdueshëm të kërcënimeve kibernetike.

Phishing, Ransomware dhe Malware

Phishing përdoret shpesh në luftën kibernetike. Zakonisht, phishing përfshin dërgimin e e-maileve të rreme për marrësit që nuk dyshojnë. Dërguesi mund të paraqitet si një institucion financiar i

respektuar, një mik, një bashkëpunëtor ose një anëtar i familjes. Këto sulme phishing mund të përdoren për të vjedhur të dhëna, për të përhapur gënjeshtër, apo edhe për të prishur rrjetet fiskale në sistemet dixhitale qeveritare dhe komerciale. Ransomware e çon luftën kibernetike një hap më tej. Këto sulme konsistojnë në enkriptimin dhe shpërblimin e të dhënave të viktimave për të penguar aksesin. Një sulm kibernetik me ransomware mund të synojë pajisje ose shërbime kritike, si ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Hajdutët e Ransomware vjedhin nga njerëzit, korporatat dhe qeveritë duke gjetur rrugën e tyre për të kaluar dobësitë e sigurisë. Ata hakinë sigurinë dhe mbajnë peng të dhëna të ndjeshme për të frikësuar viktimat që të paguajnë. Malware i vendosur gjatë sulmeve kibernetike mund të bëjë më shumë sesa thjesht të vjedhë informacion; në shumë raste, malware përdoret gjithashtu për të dëmtuar sistemet jetike kompjuterike dhe rrjetet kompjuterike, ndonjëherë në mënyrë të pariparueshme. Këto sulme mund të ndryshojnë nga viruse të thjeshta deri te fushatat masive sullmuese kibernetike që prishin infrastrukturën thelbësore industriale ose ushtarake.

Spiunazhi Kibernetik dhe Mohimi Tradicional i Shërbimit

Spiunazhi i luftës kibernetike përfshin të huajt që sulmojnë rrjetet për të vjedhur të dhëna ose për të përgjuar komunikimet. Qeveritë dhe korporatat mund të përdorin teknologjinë e spiunazhit kibernetik për të kërkuar në bazat e të dhënave të mëdha të kundërshtarëve për materiale të ndjeshme. Në fakt, kjo taktikë e luftës kibernetike është përdorur kundër programit bërthamor të Iranit dhe infrastrukturës energjetike.

Sulmet DDoS mund të përdoren gjithashtu si pjesë e një përpjekjeje më të madhe spiunazhi. Këto sulme vërshojnë sistemet me kërkesa false dhe mund të ndërpresin operacionet dhe komunikimet jetike, duke përfshirë aktivitetet financiare dhe ushtarake.

Aplikimet e AI-së në luftën kibernetike

Mësimi i makinerisë (ML) dhe inteligjenca artificiale (AI) automatizojnë dhe përmirësojnë mbrojtjen kibernetike. AI mund të zbulojë dhe parandalojë sulmet kibernetike në infrastrukturën kritike, sistemet kompjuterike qeveritare dhe rrjetet civile.

Mësimi i makinerisë përdoret për të analizuar rrjetet masive kompjuterike dhe të dhënat e sistemit të auditimit. Ai ndihmon përpjekjet për sigurinë kibernetike duke treguar tendencat dhe anomalitë që mund të sugjerojnë një hackerim.

Algoritmet mund të programohen për të identifikuar dhe penguar sulmet e dyshuara të malware. Mësimi i makinerisë dhe teknologjia AI madje kanë potencialin për të synuar automatikisht sistemet kryesore kompjuterike dhe për të rrëzuar shumicën e ekonomive bashkëkohore.

Rrjedhimisht, ekipet e sigurisë kibernetike duhet të njihen me këto teknologji dhe dëmin që mund të bëjnë. Organizatat e sektorit publik dhe privat përdorin mjete të fuqizuara nga AI-ja kundër sulmeve të ransomware dhe DDoS, gjë që lejon monitorimin, zbulimin dhe reagimin në kohë reale ndaj sulmeve kibernetike.

Sidoqoftë, AI-ja dhe mësimi i makinerive krijojnë një situatë Catch-22. Ato lejojnë sulme kibernetike efikase dhe me shënjestër të lartë, por abuzimi i kësaj teknologjie përbën një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndikimi social dhe politik i sulmeve

Sulmet e luftës kibernetike ndaj rrjeteve dhe infrastrukturës qeveritare kanë potencialin të ndikojnë në kulturën dhe opinionin publik. Muajt dhe javët përpara zgjedhjeve politike krijojnë mundësi veçanërisht shqetësuese për fushatat e spiunazhit kibernetik dhe dezinformimit për të ndikuar votuesit dhe për të lënë efekte të qëndrueshme në demokraci.

Hakerët, të armatosur me një arsenal kibernetik, vjedhin para, grabitin të dhëna dhe përhapin gënjeshtër. Aktivitetet e tyre nervozojnë votuesit, prishin komunikimet dhe minojnë besimin te qeveritë. Disa regjime kanë përdorur operacione kibernetike për të ndikuar në punët e brendshme të vendeve të tjera, për të prishur infrastrukturën publike dhe për të shkaktuar trazira politike dhe sociale. Agjencitë e sigurisë kombëtare dhe Departamenti i Mbrojtjes duhet të punojnë më shumë se kurrë për të mbrojtur shërbimet moderne dhe rrjetet qeveritare.

Mbrojtja e agjencive nga kërcënimet e jashtme, duke ruajtur hapjen dhe aksesueshmërinë është sfiduese në një shoqëri të lirë dhe demokratike, por besimi i votuesve dhe stabiliteti i qeverisë varen nga mbrojtja e fortë e kompjuterëve dhe serverëve të kombit tonë.

Për të luftuar një numër në rritje të kërcënimeve kibernetike, NATO dhe aleatët e saj kërkojnë siguri të fuqishme kibernetike dhe koordinim ndërkombëtar. Lufta kibernetike dhe spiunazhi kibernetik kërcënojnë marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe sigurinë kombëtare. Sulmet ndaj një kombi mund të prekin të tjerët, të krijojnë ndarje politike dhe të tendosin marrëdhëniet ndërkombëtare.

Dr. Andre Slonopas

Kapiten (P) Veri Talushllari

Në nderim të 4 Korrikut, 248-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Janë katër Presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që kanë ardhur nga radhët e Ushtrisë: Xhorxh Uashington (22.2.1732-14.12.1799), Ullis Grant, Duajt Ajzenahuer (14.10.1890-28.3.1969) dhe Xhorxh H. W. Bush (12.6.1924- 31.11.2018).

Në këtë shkrim do të flasim për Ullis Simpson Grant, Gjeneralin fitimtar të Luftës Civile amerikane (12 prill 1861-26 maj 1865) dhe Presidentin e 18-të të SHBA-ve (4 mars 1869-4 mars 1877).

Është një e vërtetë e gjithëpranuar se ishte Lufta Civile midis shteteve të Veriut industrial e të zhvilluar me ato të Jugut bujqësor, të prapambetur e skllavopronar ajo që vulosi përfundimisht ëndrrën e ‘Baballarëve Themelues’ të këtij vendi, krijimin e një Republike Demokratike, shembulli dhe ëndrra e gjithë Botës. Dhe krahas emrit të Abraham Linkolnit, Presidentit të zgjuar e guximtar, është gdhendur me germa ari edhe emri i Kryekomandantit të Ushtrisë së Bashkimit, Gjeneralit Ullis Grant. Megjithëse Ullis Grant është një oficer i formuar në Shkollën e Kadetëve në “West Point-in” e famshëm edhe sot e kësaj dite, dhe në fillimet e karrierës u pagëzua në betejat e Luftës Meksikane, përsëri karriera e tij është atipike për konceptet tona, por e kuptueshme për mënyrën si u krijuan e funksionuan institucionet amerikane para e pas shpalljes së Pavarësisë, përfshi edhe Ushtrinë.

Ullis S. Grant u lind në Georgetown, Ohio, më 27 prill 1822 dhe pati një fëmijëri “pa ngjarje” siç thotë vetë. Ai shkoi në shkollë, bëri punë shtëpie, rrëshqiti në akull, shkoi për peshk, kalëroi, si të gjithë fëmijët e tjerë. Në “West Point” ai studio balistikë, fortifikim dhe inxhinieri civile. Vitet e shërbimit në frontin e largët jugor me Meksikën, (Lufta Meksikano-Amerikane (1846-1848), pak zbuluan dhe frymëzuan nga tiparet që do të spikasin më vonë, sidomos për aftësitë e tij komanduese, atë që quhet “leadership” i tij. Megjithatë aty Granti i ri pa dhe provoi në kurrizin e tij luftën, sidomos anët e errëta të saj, vuajtjet, mundimet e patjetër vrasjet e njerëzve. Dhe megjithëse me pikëpamje republikane dhe ushtar i bindur në zbatimin e urdhrave dhe detyrave, ai e dënonte këtë luftë si të padrejtë, një luftë imperialiste siç vlerësohet dhe sot që i mori Meksikës gjysmën e territorit të saj, ato ku janë shtetet e Kalifornisë së sotme, Nju Meksikos, Arizonës dhe pjesë të Kolorados, Nevadës the Jutës.

Major (P) Haxhi SEJDARASI
Kapiten (P) Veri TALUSHLLARI

Festimi i “4th of JULY”, Ditës së Pavarësisë së SHBA-ve, një traditë e bukur e Shoqatës “SKËNDERBEJ USA” në Njewe York. Qëkurse u krijua, 7 vjet më parë, Shoqata e Ushtarakëve Shqiptarë “Skënderbej USA” në Nju Jork e ka kthyer në një traditë festimin e 4 Korrikut, Ditës së Pavarësisë së SHBA-ve, që këtë vit shënon 248-vjetorin. Nuk mund të mos e festonim edhe këtë vit, madje jemi ndër organizatat e para që ngritëm siparin e Festës. Grupi organizator me të palodhurit Gëzim Shentolli dhe Flutura Zekaj kanë zgjedhur një sallë plot dritë e hapësirë në Bronx, restorantin “Pine” në Bronxdale Avenue, e cila mesditën e të dielës fillon e merr gjallëri nga ushtarakë në pension e të liruar që jetojnë në zonën e Nju Jorkut. Kuptohet, ata që janë më larg vijën më herët dhe ja, kur hyjmë aty gjejmë Besnik Pazen dhe Ismet Tollen, që kanë ardhur nga New Jersey, dhe ende pa porositur kafën e mirëseardhjes, në lokal hyjnë shokët dhe kolegët tanë të Forumit të Ushtarakëve të Shoqatës Atdhetare “Bijtë e Shqipes” nga Filadelfia. Janë Ali Sopi, Kryetari i Forumit, Niko Salavaçi, Haki Çollaku dhe Petrit Zanaj, që kanë ardhur të festojnë bashkë me ne. Siç kemi vajtur dhe ne, në festat e tyre, një shkëmbim i gëzuar urimesh e mbështetje mes miqsh të vjetër e kolegësh.

E dalëngadalë salla gjallërohet nga zëra burrash e grash, të qeshur e të veshur bukur si për festë, që takohen me mall e pyesin për shëndetin dhe të rejat. Ndërkohë salla mbushet me tingujt e Himnit Amerikan “The Star - Spanglet Banner” dhe më pas Himnit Shqiptar “Rreth Flamurit të Përbashkuar” që të gjithë i këndojnë me shpirt e dorën në zemër.

Presidenti i Shoqatës, Prof. Asc. Dr. Gëzim Mustafaj përshëndet të pranishmit dhe iu uron mirëseardhjen, e më pas bën një historik të shkurtër të 4 Korrikut 1776, ditë kur Kongresi i Dytë Kontinental, ku përfaqësoshin 13 kolonitë e Mbretërisë së Bashkuar miratoi Deklaratën e Pavarësisë, duke shënuar lindjen e një kombi të ri, i cili do të shënonte një ndryshim rrënjësor të fateve të Botës. Për fatin e kombit shqiptar, Federata që lindi në atë 4 Korrik e që sot bashkon 50 shtete e 5 territore, ishte një ogur i mirë, pasi dy herë në qindvjeçarin që shkoi bëri të mundur krijimin dhe mbijetesën e dy shteteve shqiptare në Ballkanin Perëndimor, Shqipërinë më 1919 dhe Kosovën më 1999, duke i hequr nga kthetrat grabitqare të fqinjëve tanë dhe fuqive antishqiptare europiane.

Pas përshëndetjeve të Shoqatës “Bijtë e Shqipes” dhe Kryetarit të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së për Amerikën, kolonel

Ullis S. Grant, strategu fitimtar i Luftës Civile Amerikane



Pasi u tërhoq nga jeta ushtarake iu përkushtua një numri biznesesh, por nuk pati ndonjë sukses të madh. Me një gjendje të pasigurt ekonomike, madje në prag të falimentimit e gjeti shpërthimi i Luftës Civile Amerikane, më 11.4.1861, kur ushtarët e Konfederatës së Jugut hapën zjarr mbi Fort Santer, një kështjellë në Gjirin e Charleston-it në Karolinën e Jugut, të cilën e pushtuan pas pak ditësh. “Konfederatorët e shpallën veten të huaj, - do të shkruante Granti, - prandaj ata ia hoqën vetes të drejtën për të pretenduar dhe kërkuar mbrojtjen nën Kushtetutën e SHBA-ve, duke u bërë një popull si i çdo vendi të huaj që zhvillon luftë kundër një vendi të

pavarur.” Lajmi për shpërthimin e Luftës erdhi më 15 prill, bashkë me urdhrin për rekrutimin dhe organizimin e një kompanie në Galenë, Ilinois, ku Granti jetonte me Xhulia Dent dhe katër fëmijët e tyre. Ai u zgjodh përgjegjës i grumbullimit dhe rekrutimit, la çdo punë e biznes, u nis në luftë dhe brenda tre vjetëve do të bëhej Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë dhe pas shtatë vjetësh do të bëhej President i Shteteve të Bashkuara. Por përpara këtyre Ullis Grant do të kalonte në ferrin e fushëbetëve të ashpër mes Veriut dhe Jugut dhe artin e drejtimit e komandimit do ta mësonte dhe përsoste në betejat e Belmontit (7 nëntor 1861), Fort Donelsonit (15-16 shkurt 1862) dhe veçanërisht asaj të Shilahut në Tenesin e Sipërm, në prill 1862. Kjo betejë është nga më të studiuarat në Historinë e Luftës Civile dhe Artit Ushtarak Amerikan e atij Botëror, jo vetëm për fundin fitimtar të betejës nga veriorët dhe për humbjet e tmerrshme (mbi 3400 të vrarë dhe 16000 të plagosur nga të dy palët, për të cilat Grant pati shumë probleme me Kongresin), por sidomos për mënyrën e vendosur dhe krijuese të Gjeneralit të ri, që pas një viti do ta bënte Presidentin Lincoln të thoshte: “Më duhet ky njeri! Ai lufton!” Dhe e mori pranë vetes, e bëri Gjeneral (para tij këtë gradë Kongresi ia kish dhënë vetëm George Washington) dhe i dha Kryekomandën e Ushtrisë dhe gjithë mbështetjen njerëzore dhe logjistike që Granti i kërkoj, duke mos i hyrë kurrë në planet strategjike, gjë për të cilën Gjenerali i mbeti përjetësisht mirënjohës Presidentit.

E gjitha më prapa është histori, me betejat e famshme të Vicksburgut, Çatanugës, Spotsilvanisë, North Anës, Kold Harborit dhe rrethimit të Pitsburgut, faqja më e ndritshme e së cilës është 9 prilli 1865, kur Gjenerali Robert Li, Kryekomandanti i Ushtrisë së Konfederatës, njëherësh shoku i klasës dhe miku i tij nga vitet e hershme të “West Point-it”, the vetë Gjenerali Grant firmosën në Appomattox Court House në Virxhinia, fundin e kësaj lufte të tmerrshme, pasojë e së cilës është fillimi i shkatërrimit të shkakut të saj, institucionit të turpshëm e çnjerëzor të skllavërisë dhe konsolidimi e modernizimi i SHBA-ve, të cilat në shekullin që do të vinte dhe deri në ditët tona, shënojnë fatin e Botës the dy herë, fatlumturisht, shënuan për mirë edhe fatin e Shqipërisë, Kosovës dhe të shqiptarëve në trojet e veta.

Shoqata “Skënderbej USA” feston 248-vjetorin e Pavarësisë së SHBA-ve, aleatit strategjik të shqiptarëve



Astrit Huskaj, i cili sjell edhe përshëndetjet e Komandantëve të UÇK-së, Hashim Thaçit me shokë, që padrejtësisht mbahen të burgosur në Hagë, fjalën e merr muzika festive. DJ dhe këngëtar

i njohur Argjend Lloga, dhe zërat e mrekullueshëm të këngëtarëve Kristina Marku, Hysni Kelmendi dhe anëtarit të Shoqatës sonë Agim Shiqerukaj mbushin mjedisin dhe zemrat tona, duke na ftuar në këngë e valle. Krijohet një mjedis i gëzueshëm, por edhe më të gëzueshëm e bëjnë disa vogëlushë që vrapojnë andej-këtej, hyjnë mes valltarëve, i afrohen flamurit kuq e zi dhe me duart e tyre të vockla bëjnë shqiponjën dykrenore!

Nga altoparlantët vijjnë dy urime: kolegët tanë Flutura Zekaj dhe Astrit Xhakolli kanë datëlindjen dhe në sallë shpërthen e mirënjohura “Happy birthday!” dhe duartrokitje. Ja dhe një befasi e këndshme: z. Hysni Kelmendi nuk është thjesht këngëtar me atë zë të fuqishëm e që aq bukur na sjell Himnin e ri “Mora fjalë” dhe këngë të tjera, por ky bir i Gjakovës Heroike është edhe ish-luftëtar i UÇK-së dhe pjesëtar i TMK-së the FSK-së, e për këto merita Kryesia e Shoqatës “Skënderbej” i dha “Certifikatë mirënjohje”.

Një MIRËNJOHJE u dha edhe për ish-Kryetarin e Forumit të Ushtarakëve në Filadelfia, z. Egerem Murati dhe anëtarin e nderuar të Shoqatës sonë z. Petrit Xhaferri.

Ndërkohë telekronisti i palodhur i televizionit “Kultura Shqiptare”, Adem Belliu filmon veprimtarinë tonë dhe ja ku i merr një intervistë zëvendës Presidentes së Shoqatës “Skënderbej” zj. Nadire Xhakolli Malaj, e cila bën një përshkrim të punës dhe veprimtarive të Shoqatës dhe planeve për të ardhmen.

Nuk mund të shohësh e përshkruash gjithçka ndodh në sallë, por na tërheq vëmendjen Besniku tek flet me nënën në Vlorë, e pasi e pyet për shëndetin, e kthen kamerën nga Petriti dhe pyet nënën:

- Po këtë djalë e njeh?
- Po ç’ djalë është ai mo i zi, ai është më i thinjur se ti!
- Po e ke mbajtur në prehër moj! Është djali i xha Myrtos!
- Uuuu Petriti, e si je a të keqen? ...dhe fillon një bisedë malli e kujtimesh.

Ja dhe një thirrje tjetër nga Tirana, është Bujar Hasani, ish-Presidenti i Shoqatës sonë, i rikthyer në Atdhe, që përshëndet festuesit.

Ja kështu kaluan rreth 4-5 orë të gëzueshme dhe me urimin për shëndet e gëzime, ndahemi për t’u takuar në veprimtari të tjera.



Lideri i krahut ushtarak të Ismail Qemalit, është lindur më 15 janar 1864, në Buletin, por me prejardhje ishte nga fshati Isnqi i Deçanit dhe njihej si Isa Shala. Ishte ushtar dhe pjesëmarrës në Lidhjen e Prizrenit më 1878.

Ishte kryengritës shqiptar në Vilajetin e Kosovës, pjesëmarrës në rini në veprimet e Lidhjes së Prizrenit. Më pas shërbeu si kryetar i rojeve të pallatit sultanor, prej ku u kthye me (grada) dhe çifligje, pas ardhjes së xhonturqve dhe masave të tyre drejtoi kryengritjet e 1910 dhe atë të 1912. U caktua ndër rojet e Princ Vidit gjatë sundimit të tij jetëshkurtër. U vra gjatë një shkëmbimi zjarri me malazezët në Podgoricë së bashku me 17 shoqëruesit e vet.

U lind në kullën e familjes në Boletin, Isnqi, Deçan asokohe në sundimin e Perandorisë. Gjatë kohës së tij në Stamboll, katër nga fëmijët dhe nipat e tij u regjistruan në Aşiret Mektebi (shkolla e fiseve), Tafil Boletini vijoi duke ndjekur shkollën “Harbiye” (Akademinë Ushtarake).

Në vitet 1881-1907, pas ngritjes së Lidhjes së Prizrenit, Isa Boletini mori pjesë në betejën e Slivovës kundër forcave të rregullta osmane, më 22 prill 1881. Manastiri i Sokolicës mbrohej nga Isa me të vëllanë e madh, Ahmetin, baza e pushtetit të tij u bë konfiskimi ilegal i pronave.

Në vitet 1898-1899 filloi të paguhej për të mbrojtur komunitetin serb ortodoks në Mitrovicë. Si shpërblim për shërbimet e tij, Serbia i dha një medalje dhe e furnizoi me armë.

Pas ndodhive në kazanë e Mitrovicës kundrejt serbëve, Perandoria Ruse i vë kusht Stambollit, hapjen e një konsullate ruse në Mitrovicë, më 7 maj 1902. Boletini shpalli se shtëpitë e mbarë shkjejve do të digjeshin po qe se do të hapej “kangjallozi i Miskovit në Mitrovicë”. Raportohet se më 29 shtator iu dorëzua autoriteteve osmane dhe se do të falej për bëmat e tij të deriatëhershme, më 24 nëntor mbërriti në Stamboll, ku u caktua në krye të dyfekxhinjve, siç ishte mënyra e qeverisjes e Sulltan Abdyl Hamidit për të bërë për vete krerë të zëshëm vendorë, iu dha vendimi për të filluar punimet te Fabrika e Gurëve të Mullinjve në Boletin, si dhe iu akordua titulli “bej”.

Pasi shërbeu si kreu i dyfekxhinjve për katër vite, u kthye me çifligje që i ishin caktuar si shpërblim për shërbimin dhe grada ushtarake në milicinë vendore.

U bë njeriu më i famshëm dhe më i pasur i Mitrovicës, mblodhi pasues të armatosur dhe mblodhi armatime e financime si nga serbët, duke pasur gjithashtu një linjë telegrafike drejtpërdrejt me Pallatin “Jëlldëz”, si kapedan vendor i sulltanit.

1908-1911

Gjatë Revolucionit Xhonturk, më 1908, u bë një mbledhje e madhe e ulemave dhe parisë shqiptare, njohur si Kuvendi i Ferizajt për të përkrahur rikthimin e kushtetutës, ndërsa Boletini me krerë të tjerë e shihnin këtë si shenjë pabesie ndaj sulltanit. U tërhoq nga kuvendi para se të merrej ndonjë vendim, duke kuptuar dobësinë e pozitave të tij. Thuhej se sulltani i kishte kërkuar ndihmë Boletinit që të zhbënte kuvendin e mbajtur në Ferizaj. Ai ishte besnik ndaj sulltanit ndonëse më 1908 i kishte ndihmuar fillimisht xhonturqit.

Komiteti “Bashkim e përparim” pas gati një muaji të kthimit të Kushtetutës vendosi t’i jepte vëmendje gjakmarrjes në Vilajetin e Kosovës, dhe nga fundi i vitit masa të ashpra u morën nga vendorët. Nexhip bej Draga me anëtarë të tjerë të parisë së Kosovës e shihnin Boletinin si pengesë dhe besnik të sulltanit dhe lobi për ndalimin dhe arrestimin e tij, Draga donte vendosjen e rendit të ri ligjor, ndërsa

● Në fillim të Luftës së Parë Ballkanike, ushtria osmane u mbështet nga vullnetarët dhe trupat e çrregullta shqiptare, autoritetet osmane furnizuan Isën me 65,000 armë për trimat e tij për të mbrojtur trojet shqiptare brenda Perandorisë Osmane, gjë që i zhgënjeu serbët. Në shtypin serb raportohej se gjatë dorëzimit të kryengritësve shqiptarë në Lumë, Isa Boletini me trimat e tij u arratisën. Nga Dibra njoftoi për pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës.

Boletini donte privilegjet e vjetra caktuar nga koha e sulltanit. Pasi ia arriti të ndërhynte përmes Komitetit të Selanikut që qeveria të merrte masa ndaj Boletinit, i dërguan një oficer të shoqëruar për t’i dhënë Boletinit një urdhër gjykate që t’i kthente të quajturit Haxhi Alisë çifligun që kishte qenë më parë i tij para se t’ia jepte sulltani.

Boletini përqeshi urdhrin, përzuri autoritetet që më pas e sulmuan, Isa mundi të ikte me njerëzit e tij, por kulla iu dogj. Mytesarifi i Pejës këshilloi autoritetet qendrore osmane se veprimet ndaj Isës nuk do të çonin drejt ndonjë rrugëzgjdhjeje, por duhej bërë një demonstrim force në mbarë vilajetin për të bindur krerët e tjerë vendorë. Gjatë kundër-revolucionit të prillit 1909, Isa me krerë të tjerë i ofruan sulltanit ndihmën e tyre. Më 15 maj 1909 Xhonturqit, duke vazhduar mohimin e të drejtave kombëtare shqiptare, vijuan me fushata kundër atyre që nuk paguanin taksat e reja të caktuara në Stamboll.

Në Mitrovicë u caktua gjeneral i brigadës 18 Xhavid Pasha, ku zëvendësoi Shemsi Pashën e vranë (vëllain e Isës), për të përvijuar një vazhdë operacionesh ndaj malësorëve shqiptarë për dorëzimin e armëve dhe në veçanti për ta kapur.

Ishte ndër konspiruesit dhe organizatorët e kryengritjes së 1910 me Hoxhë Said efendiun, Nexhip bej Dragën, Hasan Prishtinën, Mehmet pashë Derallën, Rexhep Mitrovicën, Bedri Pejanin, Salih Gjukën dhe Idriz Seferin.

Isa me shumë krerë të tjerë të Pejës e Gjakovës mbajtën qëndrim ndaj trupave osmane, gjë që çoi drejt gjakderdhjesh dhe bombardimin e fshatrave shqiptare. Pas revoltave të herëpashershme në Vilajetin e Kosovës, në prillin e 1910 qeveria xhonturke vendosi krijimin e një korpusi ushtarak të posaçëm për “shtrimin” e Shqipërisë, në krye të të cilit u vu gjenerali Turgut Pasha. Në bashkëpunim me Idriz Seferin dhe krerët shqiptarë, Isa i priu betejave të rënda në grykën e Kaçanikut, Zagovac, Cernalevë, Kabash e Virnaglava. Në Cernalevë kryengritësit e mbajtën ushtrinë osmane për dy ditë.

Ikanakët kosovarë gjetën strehim në Mal të Zi që herët me ndodhitë e 1909, ku Knjaz Nikolla shpresonte t’i kishte ata si

ndihmë më pas gjatë zgjerimit në trojet shqiptare. Isa me të vetët ishin atje, u takua me krerë shqiptarë, merrte ndihma dhe armatim nga Mali i Zi, duke e përdorur kështu si bazë. Fillimisht Mali i Zi e shpërfilli praninë e tij, por pas kërkesave të ambasadorit osman e eskortoi larg kufirit.

Kryengritja e 1912 dhe Autonomia e Shqipërisë

Në pragun e revoltës, qeveria serbe punoi me disa banda kaçake shqiptarësh që të ishin të gatshme të vendosnin në vështirësi osmanët dhe me atë qëllim iu vardisën edhe Boletinit përmes organizatës terroriste “Dora e Zezë”. Më 23 prill 1912, njerëzit e Hasan Prishtinës çuan krye në Malësinë e Gjakovës dhe u përhapën më tej. Më 20 maj së bashku me krerë të tjerë, Boletini mori pjesë në kuvendin e Junikut, ku u dha besa dhe u nënshkrua një shpallje, për t’i shpallur luftë qeverisë xhonturke përmes kryengritjes së armatosur në Vilajetin e Kosovës. Shqiptarët e Sanxhakut të Prishtinës të kryesuar nga Isë Boletini, Xhemal beg Prishtina dhe Beqir agë Vulçiterna i thyen turqit në Llap e Gollak dhe më pas zunë Prishtinën me pëlqimin e banorëve, kundrejt komandantit vendor.

Krerët mësynë Shkupin, të cilin e zunë më 12-15 gusht të 1912, së bashku me Riza Begin mendonte të shkonte në Selanik për të liruar sulltanin dhe nuk ishte për autonomi sipas Hasan Prishtinës. Më 18 gusht Prishtina arriti t’i bindte krerët luajalistë që të binin në ujdj me autoritetet osmane për të drejtat sociopolitike e kulturore shqiptare. Boletini u kthye për në shtëpinë e vet pas premtimeve për autonomi vilajeteve shqiptare.

Luftërat Ballkanike dhe Pavarësia Shqiptare

Në fillim të Luftës së Parë Ballkanike, ushtria osmane u mbështet nga vullnetarët dhe trupat e çrregullta shqiptare, autoritetet osmane furnizuan Isën me 65,000 armë për trimat e tij për të mbrojtur trojet shqiptare brenda Perandorisë Osmane, gjë që i zhgënjeu serbët. Në shtypin serb raportohej se gjatë dorëzimit të kryengritësve shqiptarë në Lumë, Isa Boletini me trimat e tij u arratisën. Nga Dibra njoftoi për pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës. Nga 8 deri më 11 të vjeshtës së tretë bujti te Hasan bej Biçakciu në Elbasan së bashku me Mehmet pashë Dërrallën dhe Ajdin bej Dragën, u nisën të nesërmen me Mid’hat bej Frashërin pasi pritën përfaqësuesit e Dibrës me Myfti Vehbiun. Më 29 të vjeshtës së tretë, Isa mbërriti në Asamblenë e Vlorës si përfaqësues i Mitrovicës. Nën drejtimin e Mehmet Pashës, së bashku me Riza Beun kishte detyrë të organizonte milicinë kombëtare.

Më 1 prill 1913, së bashku me Ismail Qemalin, të birin Qamilin, Mark Kakarriqin dhe Gurakuqin i hipën jahtit të Dukës së Montpensier-it dhe zbritën në Brindisi. Pas bashkimit të Esad pashë Toptanit me qeverinë e Vlorës, shihej me armiqësi nga qeveria aty, sipas Fejzi bej Alizotit ishte vendosur mes Isës, Salih Gjukës dhe Gurakuqit që ta vrisnin pashain porsa të shëtiste mbi urën e skelës dhe ta hidhnin në det. Pasi ia kishin komunikuar Ismail Beut, kishte thënë se po të veprohej me vrasjet e njëri-tjetrit që në formim të shtetit shqiptar, do të merrte valixhet e do të ikte.

Më 23 shtator, shqiptarët e Dibrës u hodhën në revoltë kundër serbëve. Gjashtë mijë forca të udhëhequra nga Isa dhe Bajram Curri kaluan kufirin dhe, pas një beteje, morën Dibrën, ku vranë disa oficerë dhe i dëbuan të tjerët nga qyteti. Ushtarët që shpëtuan ia mbathën nga ana tjetër e lumit Radikë, më pas serbët nuk vonuan dhe u hakmorën me mizori të skajshme, sidomos në krahinën e Lumës. Pas pak muajsh ai u largua nga Vlora sa qe pa dhënë dorëheqjen Ismail Qemali, mori një shtëpi me qira në Shkodër.



REKRUTIM
FORCAT E ARMATOSURA
TE SHQIPËRIE



NE JEMI
NATO



FORCAT E ARMATOSURA KANË HAPUR REGJISTRIMET PËR:

- **444 kuota rekrutimi për Ushtar/Detar aktiv** (Afati i dorëzimit të dokumentacionit deri më 26 gusht 2024)
- **30 kuota studimi pasuniversitar për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura** (Afati i dorëzimit të dokumentacionit deri më 23 gusht 2024)
- **5 kuota studimi në Këmbësori, Detari, Aviacion dhe Mjekësi, në akademitë ushtarake të Turqisë** (Afati i dorëzimit të dokumentacionit deri më 15 korrik 2024)
- **5 kuota studimi në Këmbësori, Detari, Mjekësi, Psikologji dhe Infermieri, në akademitë ushtarake të Greqisë** (Afati i dorëzimit të dokumentacionit deri më 19 korrik 2024)

Mënyra e aplikimit:

*www.mod.gov.al/rekrutim
e-mail: info.afa@aaf.mil.al*

*Adresa: Ruga e Dibrës, Tiranë (ne mjediset e garnizonit "Skënderbej")
Telefon. +355683404896*